



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

*Ministria e Punëve të Brendshme dhe Administratës Publike
Ministarstvo Unutrašnjih Poslova i Javne Uprave - Ministry of Internal Affairs and Public Administration*

RAPORTI PËR IMPLEMENTIMIN E REFORMËS SË ADMINISTRATËS PUBLIKE PËR VITIN 2019: STRATEGJIA PËR MODERNIZIMIN E ADMINISTRATËS PUBLIKE (SMAP) 2015-2020

*Përgatitur nga Departamenti për Reformën e Administratës Publike dhe Integrimet
Evropiane (DRAPIE)*

Mars 2020

Tabela e Përmbajtjes

Lista e shkurtesave..... Error! Bookmark not defined.

<i>Hyrje</i>	<i>Error! Bookmark not defined.</i>
<i>Përmbledhja Ekzekutive</i>	<i>Error! Bookmark not defined.</i>
<i>Niveli i përgjithshëm i zbatimit të reformave</i>	<i>Error! Bookmark not defined.</i>
Tabela 1: Procesi i zbatimit të reformave në nivel të treguesve. <i>Error! Bookmark not defined.</i>	
<i>Shërbimi Civil</i>	<i>Error! Bookmark not defined.</i>
Sfidat	<i>Error! Bookmark not defined.</i>
Hapat e Ardhshëm	<i>Error! Bookmark not defined.</i>
<i>Shërbimet Publike Administrative dhe Procedurat Administrative..</i> <i>Error! Bookmark not defined.</i>	
Sfidat	<i>Error! Bookmark not defined.</i>
Hapat e Ardhshëm	<i>Error! Bookmark not defined.</i>
<i>Llogaridhënja dhe Organizimi i Administratës Shtetërore</i>	
Sfidat	<i>Error! Bookmark not defined.</i>
Hapat e Ardhshëm	<i>Error! Bookmark not defined.</i>
Tabela 2: Procesi i zbatimit të reformave në nivel të aktiviteteve.. <i>Error! Bookmark not defined.</i>	
Shërbimi Civil	<i>Error! Bookmark not defined.</i>
Shërbimet Publike Administrative dhe Procedurat Administrative..... <i>Error! Bookmark not defined.</i>	
Llogaridhënja dhe Organizimi i Administratës Shtetërore..... <i>Error! Bookmark not defined.</i>	

Shkurtesat

ASHI
DASHC
ZKM

Agjencia e Shoqërisë së Informacionit
Departamenti i Administrimit të Shërbimit Civil
Zyra e Kryeministrit

DRAPIE	Departamenti për Reformën e Administratës Publike dhe Integrimi Evropian
IKAP	Instituti i Kosovës për Administratë Publike
IRK	Institucionet e Republikës së Kosovës
MAP	Ministria e Administratës Publike
MPB	Ministria e Punëve të Brendshme
MF	Ministria e Financave
RAP	Reforma e Administratës Publike
SIMBNJ	Sistemi Informativ i Menaxhimit të Burimeve Njerëzore
SMAP	Strategjia për Modernizimin e Administratës Publike
SHCK	Shërbimi Civil i Kosovës
MBS/ SBS	Mbështetja Buxhetore Sektoriale
VNT	Vlerësimi i Nevojave të Trajnimit
LPPA	Ligji për Procedurat e Përgjithshme Administrative
OSHC	Organizatat e Shoqërisë Civile
DL	Departamenti Ligjor
AIP	Agjencia për Informim dhe Privatësi
DMZP	Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik
GVRAP	Grupi i Veçantë për Reformën e Administratës Publike
KMRAP	Këshilli i Ministrave për Reformën e Administratës Publike
ZKA	Zyra Kombëtare e Auditorit

Hyrje

Ky raport shqyrton dhe analizon procesin, rezultatet dhe sfidat në kuadrin e zbatimit të Strategjisë së Modernizimit të Administratës Publike (SMAP 2015-2020), për periudhën kohore 1 Janar – 31 Dhjetor 2019. Në vitin 2019, qeveria e Republikës së Kosovës ndërmori një sër veprimesh vendimtare dhe tejet të rëndësishme për reformimin dhe modernizimin e administratës publike, kryesorja mes tyre ishte miratimi i Pakos Legjislative të RAP, nga Kuvendi i Kosovës, e cila përbëhej nga Ligji për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura; Ligji për Zyrtarët Publik; dhe Ligji për Pagat në Sektorin Publik (në tekstin e mëtejme: pako legjislative e RAP). Këto tre ligje, krijojnë ndryshime të rëndësishme në administratën publike dhe përgjigjen në mënyrë efektive ndaj sfidave kryesore në administratën publike të Kosovës.

Ligji për Zyrtarët Publik ndryshon tërësisht procedurat dhe metodologjinë e rekrutimit në shërbimin civil duke mundësuar një rekrutim të centralizuar si dhe testim të dixhitalizuar për kandidatët. Ligji për Pagat në Sektorin Publik, për herë të parë, krijon një sistem të unifikuar për mbi 82-mijë nëpunës që marrin pagë nga Qeveria e Kosovës, duke krijuar transparencë, përgjegjshmëri dhe duke parandaluar abuzimin dhe harxhimin e fondeve publike. Ligji për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura, krijon për herë të parë një politikë në lidhje me krijimin dhe përgjegjshmërinë e agjencive të pavarura. Për më tepër, në vitin 2019 qeveria ndërmori hapa të rëndësishëm në përmirësimin e aksesit/ qasjes, ofrimit dhe përballueshmërisë së shërbimeve publike përmes One Stop Shopeve, si dhe zhvillimit të platformës së ndërveprimit (Interoperabilitetit) për dixhitalizimin e shërbimeve.

Një ndër sfidat kryesore me të cilat është përballur qeveria në vitin 2019 për të shtyer përpara axhendën e RAP, padyshim përfshin zhvillimet politike që kanë të bëjnë me dorëheqjen e Kryeministrit në korrik 2019 që pasuan me mbajtjen e zgjedhjeve të parakohshme. Përveç kësaj, riorganizimi i Ministrisë së Administratës Publike dhe bashkimi në Ministrinë e Punëve të Brendshme ka gjeneruar sfida të rëndësishme në fillim të vitit 2020, veçanërisht kur Ministrisë j'u hoq si udhëheqja politike ashtu edhe mbikëqyrja administrative ku roli i zyrtarit kryesor administrativ (Sekretari i Përgjithshëm) në ministri ishte i ngrirë. Sfidat e tjera të vazhdueshme që ndikojnë në zbatimin e axhendës së RAP, përfshijnë kapacitetet e dobëta në të gjithë sektorin publik, planifikimin e dobët, mungesën e bashkëpunimit dhe koordinimit të duhur ndërinstucional - gjë që ka ndikuar veçanërisht në aftësinë e qeverisë për të digjitalizuar shërbimet publike. Një sfidë tjetër e rëndësishme përfshin mungesën e qartësisë për të ardhmen e kornizës strategjike të RAP dhe duke marrë parasysh që (SMAP 2015-2020) përfundon në vitin 2020, njëherit edhe Strategjia e Reformës në Menaxhimin e Financave Publike përfundon në këtë vit.


Gjatë vitit 2019, u krijua korniza kryesore institucionale për të monitoruar zbatimin e kornizës strategjike të RAP. Në maj, KMRAP mbajti mbledhjen e tij, ndërsa në qershor u zhvillua takimi i GVRAP, midis qeverisë së Kosovës dhe Komisionit Evropian. Të dy takimet njohën progresin e zhvilluar në kuadër të pakos legjislative të RAP, ndërsa nënvizuan edhe sfidat.

Në vazhdimësi Shoqëria Civile u këshillua dhe u informua për axhendën e RAP. Në maj, në kuadër të përgatitjeve për mbajtjen e GVRAP, u mbajt një takim gjithëpërfshirës me organizatat joqeveritare për të shqyrtuar axhendën dhe çështjet që do të trajtoheshin në takim. Përveç kësaj, 2019 vazhdoi të ishte një vit aktiv në lidhje me përfshirjen e shoqërisë civile në Inicativën e të Dhënave të Hapura të qeverisë. Ky raport është i organizuar në seksionet si në vijim. Seksioni në vazhdim jep një përmbledhje të përgjithshme të veprimeve të reformës të zbatuara përgjatë viti 2019 në përputhje me Planin e Veprimit 2018-2020 për zbatimin e Strategjisë së Modernizimit të Administratës Publike 2015-2020 (PVSMAP 2018-2020). Seksioni i dytë ofron një përmbledhje totale të procesit të zbatimit të reformave me fokus në treguesit e performancës. Ndërkaq, tri seksione vijuese ndahen në tre objektiva të përgjithshëm nga PVSMAP 2018-2020, dhe ofrojnë detaje të mëtejshme mbi procesin e zbatimit, sfidat

dhe hapat e ardhshëm. Raporti gjithashtu përmban një tabelë me një përmbledhje të detajuar të zbatimit të aktiviteteve të reformës.

Përmbledhja Ekzekutive

Reforma e administratës publike mbetet një ndër prioritetet kryesore për qeverinë e Republikës së Kosovës. Në vitin 2019, Qeveria vazhdoi të zbatojë Planin e Veprimit 2018-2020 për zbatimin e SMAP 2015-2020 (PVSMAP 2018-2020) si dhe, Kontratën për Reformën Sektoriale për Reformën e Administratës Publike (KRS-RAP). PVSMAP 2018-2020, është e organizuar në tre objektiva të përgjithshme, dhe ato janë të organizuara në objektiva specifike që janë të organizuar në aktivitete. Secili objektivi i përgjithshëm si dhe objektivat specifike kanë indikatorët matës të tyre të veçantë. Gjatë vitit 2019 zbatimi i masave të planifikuara ishte 30%, ose gjithsej 12 aktivitete të implementuara me sukses nga gjithsej 40 aktivitete që ishin planifikuar. Në fund të vitit 2019, gjithsej 28 aktivitete (70%) ishin akoma nën zbatim ose kishin ngecur (shih tabelën 2 për më shumë detaje). Në lidhje me treguesit, niveli i zbatimit të treguesve të SMAP për vitin 2019 është 19%, ose janë arritur gjithsej 7 tregues, ndërsa 29 tregues tjerë janë nën zbatim ose kanë ngecur (shih tabelën 1 për më shumë detaje).




Në kuadër të objektivit të përgjithshëm (1) **“Një sistem adekuat i avancuar për menaxhimin, monitorimin dhe zbatimin e legjislacionit për shërbimin civil dhe krijimi i mundësisë për një shërbim civil profesional, efektiv dhe efikas, zhvillimi i të cilit është e bazuar në parimet e administratës së mirë dhe të orientuar kah zbatimi i obligimeve”**, janë planifikuar gjithsej 19 aktivitete, dhe vetëm 4 janë zbatuar. Klasifikimi i vendeve të punës në përputhje me ligjin e ri për pagat në administratën publike, dhe integrimin e të dhënave personale dhe atyre të punësimit të nëpunësve civilë në mënyrë elektronike nga dosjet fizike në Sistemin e Informacionit për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore (SIMBNJ), nga të gjitha institucionet. Këto dy veprime reformuese janë arritje të rëndësishme, veçanërisht për të siguruar një menaxhim më të mirë dhe më efektiv të burimeve njerëzore në administratën publike. Përdorimi efektiv i SIMBNJ-së, do t’i lejojë qeverisë gjithashtu të rrisë përgjegjshmërinë, si dhe transparencën e punës së administratës publike. Si shtrirja horizontale ashtu edhe niveli i shfrytëzimit të SIMBNJ-së janë tregues i suksesit të axhendës së RAP dhe të përfshira në PVSMAP 2015-2020.

Në lidhje me objektivin e përgjithshëm (2) **“Shërbimet publike administrative janë lehtësisht të qasshme, me qendër të përdoruesit, duke ndjekur procedurat administrative të cilat përmirësohen vazhdimisht në bazë të informatave kthyesë të përdoruesve”**, janë planifikuar gjithsej 8 aktivitete, dhe vetëm 3 janë

zbatuar. Qeveria ka integruar me sukses 40 sisteme në platformën e ndërveprimit, e cila është një arritje kryesore drejt dixhitalizimit të shërbimeve publike, e cila do të përmirësojë në masë të madhe mundësinë e ofrimit të shërbimeve për qytetarët dhe komunitetin e biznesit. Njëherit, qeveria implemetoi një studim për të matur opinionin publik mbi mundësinë e qasjes dhe cilësinë e shërbimeve publike, e cila u bazua në kornizën metodologjike të rënë dakord më parë. Janë përfshirë gjithsej 18 institucione, dhe janë anketuar 5,219 qytetarë për cilësinë dhe aksesin e më shumë se 200 shërbimeve publike që ofrohen nga institucionet qendrore dhe ato lokale. Pas anketës, u përgatitën dy raporte të ndara. Një raport i përgjithshëm për rezultatet e studimit dhe raportet speciale për secilin institucion që ka marrë pjesë në studim për qëllim që të identifikojnë mangësitë, si dhe të përmirësohen në përputhje me rrethanat. Qeveria planifikon të publikojë raportin e përgjithshëm në tremujorin e dytë të vitit 2020.


Për sa i përket **“Administratës publike transparente, të përgjegjshme racionale, me organizim të qartë, racional dhe me linja të qarta të llogaridhënjes mes organeve të administratës publike”**, janë planifikuar gjithsej 13 aktivitete, dhe janë zbatuar 5 aktivitete. Në kuadër të këtij objekti, gjatë vitit 2019 u zbatuan dy aktivitete të rëndësishme reformuese. Së pari, Kuvendi i Kosovës miratoi ligjin e ri për Qasjen në Dokumente Publike dhe Informata (Nr. 06/ L-081). Një nga reformat kryesore të paraqitura me këtë ligj përfshin detyrimin për të gjitha institucionet që të hapin të dhënat e tyre, gjë që në fakt do të rrisë më shumë transparencën e qeverisë dhe do të mbështesë procesin e vendimmarrjes bazuar në pjesëmarrje. Të gjitha institucionet, kanë caktuar zyrtarët përgjegjës në të gjitha institucionet publike (146 zyrtarë). Qeveria zbatoi gjithashtu një fushatë promovimi për të dhënat e hapura siç ishte planifikuar në PVSMAP 2015-2020, në partneritet të ngushtë me organizatat e shoqërisë civile.

Së dyti, në vitin 2019 qeveria miratoi planin e veprimit për racionalizimin e agjencive i cili do të përmirësojë më shumë përgjegjshmërinë e administratës publike. Rregullorja për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës ka përfunduar gjithashtu.



Rishikimi i të dhënave për aktivitetet reformuese të implementuara tregon se DASHC, në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme u përball me sfida të mëdha në zbatimin e aktiviteteve të planifikuara të reformës. Përveç kësaj, aktivitetet e reformës që kanë të bëjnë me dokumentet e politikave dhe ligjet, gjithashtu përfaqësojnë një pjesë të rëndësishme të aktiviteteve të reformave të

pa zbatuara. Arsyet për këtë kanë të bëjnë kryesisht me faktin se në vitin 2019 hyri në fuqi pakoja legislative për RAP, dhe në kuadër të kësaj Ligji për Zyrtarët Publikë, parashikonte krijimin e një Departamenti të ri për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë (DMZP), ndërsa zhvillimet politike (vakumi institucional) penguan përpjekjet për të miratuar legjislacionin sekondar për të zbatuar në tërësi pakon legislative të RAP.



Një ndër storiet më të rëndësishme të suksesit për vitin 2019 pa dyshim është aprovimi nga Kuvendi i Kosovës i pakos legislative të RAP, sepse shënoi kulmimin e viteve të tëra të përpjekjeve për të krijuar një reformë gjithëpërfshirëse të shërbimit civil dhe administratës shtetërore. Një storie tjetër kryesore e suksesit për vitin 2019 përfshin përpjekjet e ish -MAP për të zbatuar nismën për të dhëna të hapura (ODRA). Në fillim të vitit 2019, qeveria miratoi një politikë të zhvilluar nga MAP, duke vendosur për herë të parë një strukturë dhe politikë të qartë për Iniciativën e të Dhënave të Hapura. MAP, gjithashtu krijoi një njësi të dedikuar veçantë për menaxhimin e ODRA në Agjencinë për Shoqërinë e Informacionit. Portali për të dhënat e hapura përmban mbi 190 grupe të të dhënave nga institucione të ndryshme të qeverisë, të cilat u përdorën në të dhënat e hapura.¹

Agjencia për Shoqërinë e Informacionit (ASHI) në partneritet me akterët kryesor të shoqërisë civile, Qendrën e Inovacionit në Kosovë (ICK) dhe mbështetur nga Open Data Kosova (ODK), hasi në sfidën e parë të vizualizimit të të dhënave të hapura nga qeveria! Qëllimi ishte të edukohet dhe të frymëzohej publiku i gjerë për të gjeneruar këndvështrime të reja për përdorshmërinë e të dhënave dhe vendimeve të drejtuara nga të dhënat, me theks në të dhënat e hapura të qeverisë pasi fuqizon një grup të gjerë qytetarësh që të shtyjnë kufijtë e qeverisë së hapur. Tre çmime j'u ndanë garuesve në tre tema: Infografikë; Një blog/artikull; dhe një video animacion. Fituesi Infografikë ishte vizualizimi i të dhënave për migracionin dhe tregun e punës në Kosovë nga një grup i të rinjve.²

¹ Shih: Portali i të Dhënave të Hapura, i qasshëm në: <https://opendata.rks-gov.net/>.

² Shih: DataVIZARDS- Emigracioni dhe Tregu i Punës, i qasshëm në: <https://public.tableau.com/profile/mergim#!vizhome/DataVIZARDS-EmigracionidheTreguiPunes/Dashboard2>.

Niveli i përgjithshëm i zbatimit të reformave

Procesi i mbledhjes së të dhënave në kuadër të hartimit të raportit vjetor 2019 për zbatimin e PVSMAP 2015-2020, filloi më 28 janar 2020 kur Departamenti për Reformën e Administratës Publike dhe Integriteteve Evropiane (DRAPIE), dërgoi kërkesën për raportim tek ministritë e linjës, përmes postës elektronike, për të siguruar kontributin në statusin e zbatimit të aktiviteteve të reformës në përputhje me PVSMAP 2018-2020. Në këtë kërkesë, DRAPIE dha udhëzime të qarta dhe specifike për të dhënat e kërkuara. Në këtë drejtim, jo të gjitha institucionet u përgjigjën brenda afateve kohore të paracaktuara, njëherit një e-mail tjetër ri-kujtues j'u dërgua të gjitha institucioneve më 11 shkurt 2020, megjithatë përsëri disa institucione nuk arritën të sigurojnë, rrjedhimisht t'i dërgojnë të dhënat, dhe për këtë arsye DRAPIE, organizoi takime konsultative me palët përkatëse ndërmjet 18 dhe 20 shkurt 2020. Sidoqoftë, pavarësisht insistimeve dhe komunikimeve të vazhdueshme, disa institucione prapë se prapë nuk arritën t'u përgjigjen kërkesave për takime. Prandaj, një kërkesë e tretë ri-kujtuese përmes e-mailit për të dhëna shtesë u dërgua më 26 shkurt 2020 për institucionet që nuk janë përgjigjur. DRAPIE, zhvilloi takime të tjera shtesë këshilluese me institucionet përgjegjëse, si dhe thirrje telefonike deri më 5 mars 2020. Pas përfundimit të procesit të mbledhjes së të dhënave, u mbajtën dy takime pune me mbështetjen e SIGMA-s (më 4 dhe 10 mars 2020) për të përgatitur analizën e të dhënave. Një takim paraprak pune u mbajt më 26 shkurt 2020 për të diskutuar rreth modelit të ri të raportit.

Në këtë drejtim ekzistojnë dy sfida të rëndësishme për DRAPIE në përgatitjen e raportit vjetor. Së pari, mungesa e një sistemi uniform për mbledhjen e të dhënave dhe zbatimin e tyre. Prandaj, mbledhja e të dhënave bazohet kryesisht në metodat klasike manuale. Së dyti, mungesa e çfarëdo mënyre nga DRAPIE për të siguruar bashkëpunim nga ministritë e linjës dhe organizatat e tjera në sigurimin e të dhënave në lidhje me statusin e zbatimit të aktiviteteve në kuadër të reformës. Ekziston një nivel pakujdesie dhe mungese të seriozitetit nga ana e institucioneve që nuk raportojnë me kohë, me kualitet, dhe në përputhje me afatet e dakorduara. Në këtë drejtim, ashtu siç është paraparë me vendim të Sekretarit të MAP, ka pika kontakti për DRAPIE, në ministritë e linjës dhe organizatat e tjera për të siguruar të dhëna, por ato nuk funksionojnë në mënyrë efektive dhe shpesh të dhënat që jepen janë të vonuara dhe të një cilësie jo të kënaqshme.

Viti 2019, filloi mirë për axhendën e RAP, pasi që Qeveria e Kosovës aprovoi një vendim të propozuar nga MAP për organizimin dhe funksionalizimin e strukturave për iniciativën e të dhënave të hapura, i cili krijoi një detyrim për të gjitha organizatat qeveritare që të publikojnë të dhënat e tyre në mënyrë të paracaktuar.³ **Në shkurt të vitit 2019, Kuvendi i Kosovës miratoi pakon legjislative të RAP, pas shumë vitesh përpjekjeje dhe një procesi të konsultimit gjithëpërfshirës.** Kjo shënoi një zhvillim thelbësor për axhendën e RAP të Kosovës sepse Ligji për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura; Ligji për Zyrtarët Publikë; dhe Ligji për Pagat në Sektorin Publik transformojnë dukshëm aspektet kryesore të administratës publike. Këto ligje krijojnë një sistem krejtësisht të ri të procedurave të rekrutimit dhe avancimit në shërbimin civil, duke j'u bërë ballë në masë të madhe ndërhyrjeve politike në këtë proces, njëherit, këto ligje krijojnë për herë të parë një sistem të unifikuar për mbi 82-mijë nëpunës që janë të punësuar në sektorin publik, duke krijuar më shumë transparencë, efikasitet dhe përgjegjshmëri se si shpenzohen mbi 500-milion euro nga buxheti i Kosovës. Së fundmi, ligjet i japin fund procesit të pakontrolluar të agjencive në Kosovë, duke krijuar linja të qarta përgjegjësie dhe kriteret për krijimin e agjencive. Për më tepër, qeveria bëri përparim të madh në krijimin e One Stop Shop-it të parë në komunën e Prizrenit.

Sidoqoftë, nga mesi i vitit 2019 situata filloi të ndryshojë. Në korrik të vitit 2019, Kryeministri i Kosovës dha dorëheqje dhe qeveria si e tillë mbeti në detyrë dhe u bë një kujdestar, ndaj veprimet dhe vendimet që mund të ndërmarrë kufizoheshin. Kjo ndikoi në mënyrë të drejtpërdrejtë në aprovimin e planifikuar nga qeveria në vitin 2019 të legjislacionit dytësor në lidhje me pakon legjislative të RAP. Gjykata

³ Shih: Vendimi i Qeverisë Nr. 05/84, 15 Janar, 2019, i qasshëm në: <https://map.rks-gov.net/desk/inc/media/1E857308-A302-4B9D-B297-6E2692B6B515.pdf>.

Kushtetuese e Kosovës pezulloi zbatimin e Ligjit për Zyrtarët Publikë në 19 nëntor 2019,⁴ dhe të njëjtën gjë bëri edhe me Ligjin për Pagat në 12 dhjetor 2019.⁵ Këto zhvillime ndikuan drejtpërdrejt në aftësinë e qeverisë për të zbatuar dhe për t'i dorëzuar në axhendën e paraparë të RAP, që përfshijnë përmbushjen e treguesve nga KRS-RAP.⁶ Në parim, këto vendime nga Gjykata Kushtetuese e bëjnë më të vështirë edhe mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian për Reformën e Administratës Publike, për arsye se një numër i madh i aktiviteteve të parapara të realizohen gjatë vitit 2019, kanë ngecur si pasojë e pezullimit të Ligjit për Zyrtarët Publikë, dhe Ligjit për Paga.

Pavarësisht nga sfidat e hasura është arritur një përparim i rëndësishëm. Qëllimi kryesor i SMAP 2015-2020, dhe qasja e qeverisë së Republikës së Kosovës në lidhje me RAP, është të mbështesë zhvillimin e një administrate publike moderne dhe profesionale që ofron në mënyrë efektive shërbime të mira për qytetarët dhe komunitetin e biznesit, që është i aftë të zbatojë politikën publike dhe reformat që rrjedhin nga procesi i integritetit evropian, dhe është efektiv, transparent, dhe i përgjegjshëm. Në këtë drejtim, **qeveria e Kosovës ka vazhduar të zbatojë veprime të mëdha reformuese në mënyrë që të forcojë përgjegjshmërinë dhe profesionalizmin.** Në vitin 2019, qeveria testoi 1.800 shërbyes civilë në përputhje me kornizën konceptuale për testimin e nëpunësve civilë. Në vitin 2019, qeveria gjithashtu vuri në provë/ testoi kohën e kërkuar për rekrutimin e nëpunësve civilë, dhe rezultatet tregojnë se koha mesatare e kërkuar është më pak se 90-ditë, e cila është në përputhje me treguesit në PVSMAP 2018-2020. Këto dy rezultate kanë ndikim të drejtpërdrejtë në sigurimin e një shërbimi civil që është profesional dhe efektiv dhe nuk lejon ndërhyrjen politike. Në këtë drejtim, një tjetër rezultat i rëndësishëm ka të bëjë me mbajtjen e nëpunësve civilë të rekrutuar i cili ishte 100% në 2019, duke tejkaluar objektivin e 90% të vendosur në PVSMAP 2018-2020.

Përmirësimi i menaxhimit të burimeve njerëzore në shërbimin civil është një aspekt thelbësor i axhendës së RAP. Në këtë drejtim, grupet punuese ndërministrorë të qeverisë për klasifikimin e vendeve të punës të zyrtarëve publikë u mbajtën rregullisht, dhe një raport i detajuar për realizimin e klasifikimit të vendeve të punës në radhët dhe koeficientët përkatës në përputhje me Ligjin për Pagat në Sektorin Publikë ishte përgatitur. Katalogu gjithashtu është azhurnuar dhe plotësuar me 134 tituj të rinj të punës të standardizuar dhe tani ai përmban 1,983 tituj pune të standardizuar për nëpunësit civilë. Nga numri i përgjithshëm i 18.712 shërbyesve civilë, në katalogun e punës janë 15.212 shërbyes civilë. Këto rezultate do të rrisin shumë aftësinë e njësive përkatëse të menaxhimit të burimeve njerëzore në qeveri për të zbatuar në mënyrë efektive detyrat e tyre. Sa i përket shtrirjes horizontale të SIMBNJ, ekziston një prirje pozitive në lidhje me numrin e institucioneve që kanë qasje në të, që është 145. Sidoqoftë, në lidhje me shkallën e përdorimit të moduleve të SIMBNJ, ekziston një trend negativ dhe nuk ka qenë i suksesshëm, pasi që përqindja është relativisht e vogël me vetëm 59.63%. Është një përpjekje thelbësore për të forcuar trajnimin e shërbimit civil. Buxheti i alokuar për Institutin e Kosovës për Administrim Publik (IKAP) nga Qeveria për zbatimin e shërbimit të trajnimit për vitin 2019 arriti në 100,852 €. Me buxhetin e alokuar, IKAP ka arritur të trajnojë 3,224 nëpunës civilë ose 17.42% të totalit të 18.500 nëpunësve civilë. Mungesat dhe problemet e IKAP me buxhetin për trajnimin e nëpunësve civilë për fat të keq mbeten një sfidë në vazhdimësi.

Racionalizimi i agjencive ekzekutive dhe organeve të pavarura paraqet një përparësi për qeverinë e Kosovës, pasi shihet e rëndësishme për zvogëlimin e barrierave të panevojshme, rrisin përgjegjshmërinë, përmirësimin e ofritit të shërbimeve dhe kursimin e fondeve publike. Në këtë drejtim, qeveria e Kosovës, në përputhje me planin e veprimit të aprovuar, ka hartuar dokumentet e nevojshme legislative për të zbatuar racionalizimin. Janë përgatitur dy projektligje për transferimin e

⁴ Shih: https://gjk-ks.org/wp-content/uploads/2020/03/ko_203_19_vvmp_shq.pdf.

⁵ Po aty, <https://gjk-ks.org/vendimet/>.

⁶ MAP, lancoi konsultimet në shtator, për të përpiluar draftet e 3 rregulloreve të parapara me Ligjin për Zyrtarët Publikë; Rregullorja mbi Deklaratën e Statusit të Zyrtarëve Publikë; Rregullorja për Suspendimin, Shkarimin nga Shërbimi Civil; dhe Rregullorja mbi Diciplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publikë. Shih: <https://map.rks-gov.net/>.

tetë (8) agjencive nga Kuvendi i Kosovës në Qeveri, sidoqoftë, për shkak të zgjedhjeve të parakohshme dhe vonesave në formimin e qeverisë së re, këto projektligje duhet të pritet që të miratohen.

Përgjegjësia dhe transparencja e administratës publike është një pjesë thelbësore e axhendës së RAP të qeverisë së Kosovës. Në këtë drejtim, një rezultat i rëndësishëm është publikimi në mars 2019, i raportit për masat disiplinore ndaj nëpunësve civilë për shkelje të etikës dhe legjislacionit antikorrupsion.⁷ Gjatë vitit 2018, përgjithësisht ka pasur 82 raste të masave disiplinore ndaj nëpunësve civilë për shkelje të etikës dhe legjislacionit antikorrupsion si në nivelin qendror ashtu edhe në atë lokal. Nga këto 82 raste, 64 raste kanë të bëjnë me shkelje të rënda, ndërsa 18 raste kanë të bëjnë me shkelje të vogla. Gjatë vitit 2018, është dhënë një vendim për ndërprerjen e marrëdhënies së punës të 19 shërbyesve civilë, si rezultat i shkeljeve që ata kishin kryer. Gjatë vitit 2018, nga 82 raste, 7 ishin gra dhe 75 burra. Raporti tregon se korniza institucionale dhe ligjore e krijuar për të parandaluar abuzimin dhe korrupsionin në punët e shërbimit civilë dhe ka përgjegjësi për ata nëpunës civilë për të cilët rezultojnë se kanë shkelur etikën ose legjislacionin antikorrupsion.

Publikimi i këtij raporti ishte një nga treguesit e KRS-RAP. Për më tepër, në lidhje me transparencën në administratën publike, një rezultat i rëndësishëm për tu vërejtur është që qeveria publikoi 195 të dhëna në portalin me të dhëna të hapura që tejkaluan objektivin që ishte, për 120 të dhëna. Rreth 13 organizata qeveritare kanë publikuar të dhënat e tyre në format të lexueshëm në mënyrë mekanike duke e bërë më të lehtë për shoqërinë civile dhe komunitetin e IT-së që të monitorojnë politikën dhe punën e qeverisë, si dhe të përdorin të dhënat për interes publik dhe inovacion.

Një aspekt tjetër i rëndësishëm i axhendës së Kosovës për RAP ka të bëjë me ofrimin e shërbimeve për qytetarët dhe komunitetin e biznesit. Një nga rezultatet më të rëndësishme në vitin 2019 është zbatimi për herë të parë i matjes së opinionit publik për knaqshmërinë e qytetarëve me aksesin dhe cilësinë e shërbimeve të ofruara. Siç është përmendur tashmë, të dhënat nga ky studim janë duke u përdorur për të hartuar matjet dhe ndërhyrjet për të përmirësuar mangësitë e adresuara. Synimi në PVSMAP 2015-2020 ishte vlerësimi i vetëm 25 shërbimeve, ndërsa sondazhi përfshiu 35 shërbime. Në vitin 2019, qeveria gjithashtu bëri përparim të konsiderueshëm në krijimin e një pike të vetme të kontaktit në komunën e Prizrenit si një pilot projekt, i cili do të përmirësojë në masë të madhe qasjen dhe cilësinë e shërbimeve të ofruara nga institucionet nga niveli lokal dhe ai qendror. Kjo do të ndihmojë drejtpërdrejt qytetarët të kursejnë para dhe kohë, duke zvogëluar nevojën për të vizituar institucione të ndryshme për dokumente të ndryshme pasi ata do të jenë në gjendje të kryejnë shërbimet e tyre në një ndalesë të vetme.

Për më tepër, qeveria është në proces të zhvillimit të portalit “e-Kosova” për të ofruar shërbime dixhitale për qytetarët dhe komunitetin e biznesit dhe tashmë ka nënshkruar një kontratë me një operator ekonomik për të zhvilluar portalin. Në këtë drejtim, koncepti i dokumentit për sigurimin e shërbimeve të përqendruara përmes portalit e-Kosova është zhvilluar dhe përfunduar. Njëzet e katër (24) shërbime elektronike të institucioneve, që ofrojnë pesëdhjetë (50) lloje të transaksioneve janë integruar deri më tani në Platformën e Ndërveprimit (Government Gateway).

Ekziston një kornizë institucionale që monitoron dhe drejton zbatimin e axhendës së qeverisë për RAP. Institucioni i parë dhe kryesori në këtë drejtim është Këshilli i Ministrorëve për Reformën në Administratën Publike (KMRAP) i cili përbëhet nga ministrat e ministrive të linjës dhe zyrtarë të tjerë të lartë. Pjesëmarrja e Ministrave në KMRAP përcjell angazhimin e qeverisë në axhendën e RAP në nivelin më

⁷ Shih: MAP, Raport mbi masat disiplinore në shërbimin civil të Republikës së Kosovës gjatë vitit 2018, Ministria e Administratës Publike, Mars 2019, i qasshëm në: <https://map.rks-gov.net/desk/jnc/media/2892D16B-2334-4CEF-9889-93E8B0F0C1CE.pdf>.

të lartë politikë. Gjatë vitit 2019, KMRAP u takua vetëm një herë në 13 maj 2019.⁸ Në këtë takim zbatimi i KRS-RAP dhe dëshmipërblimet për zbatimin e pakos ligjore të RAP ishin temat kryesore të diskutimit.

Para KRS-RAP, qeveria organizoi një takim konsultativ me organizatat e shoqërisë civile në 8 maj 2019, me qëllim informimin e tyre si dhe, të kërkojë kontributin e tyre për mbledhjen e KRS-RAP si dhe, të Grupit të Veçantë për RAP (GVRAP) me Komisioni Evropian. Takimi i GVRAP u mbajt më 22 maj 2019, dhe u mirëprit miratimi i pakos legjislative të RAP, si dhe, u ritheksua mbështetja për procesin e racionalizimit të agjencive, megjithatë, shqetësimet ishin shprehur në lidhje me emërimet e larta në shërbimin civilë.

Tabela 1: Procesi i zbatimit të reformave në nivel të treguesve

Objektivi i përgjithshëm I – Sistem adekuat i avancuar për menaxhimin, monitorimin dhe zbatimin e legjislacionit për shërbimin civil dhe krijimi i mundësisë për një shërbim civil profesional, efikas dhe eficient zhvillimi i të cilit është e bazuar në parimet e administratës së mirë dhe të orientuar kah zbatimi i obligimeve.			
Baza	Treguesi / Objektivi për 2019	Statusi gjatë periudhës së raportimit	Shënim
Treguesi- Sistemi i pagave për nëpunësit civil i drejtë dhe konkurrues (Indikator i SIGMAS)			
3	4	0	Qeveria ka miratuar Ligjin e ri për Pagat në Sektorin Publik më 02 shkurt 2019, i cili do të përmirësojë ndjeshëm shkallën në të cilën sistemi i pagave për nëpunësit civil është i drejtë dhe transparent
Treguesi 1.1.1: % e vendeve të punës në shërbimin civil që janë harmonizuar me katalogun			
85%	90%	81.30%	Përqindja e realizimit të këtij treguesi në vitin 2019 është 81.30%. Nga numri i përgjithshëm i nëpunësve 18712, në katalogun e vendeve të punës, janë sistemuar 15,212 nëpunës
Treguesi 1.1.2: % e institucioneve të cilat i kanë harmonizuar vendet e punës për shërbimin civil me katalogun e vendeve të punës			
90%	90%	81.30%	Në vitin 2019, ku baza ka qenë 80%, përqindja e institucioneve të cilat i kanë harmonizuar vendet e punës për shërbimin civil me katalogun e vendeve të punës është 81.30%. Nga numri i përgjithshëm i nëpunësve 18,712 në gradat e katalogut të vendeve të punës janë të sistemuar 15,212 nëpunës civil
Treguesi 1.2.1 Shtirrja horizontale e aplikimit të SIMBNJ-së (%)			
100%	100%	100%	Numri i institucioneve në të cilat SIMBNJ është shpërndarë apo kanë qasje në të është 145 institucione, qa sa edhe ishte i planifikuar. Ky tregues është realizuar me sukses
Treguesi 1.2.2 Shkalla e përdorimit të moduleve të SIMBNJ			
45%	70%	59.6%	Shkalla e përdorimit të moduleve të SIMBNJ është 59.63%. Ky tregues nuk është realizuar me sukses
Treguesi 1.2.3 Numri i nëpunësve civil të cilët janë testuar sipas Kornizës Konceptuale për testimin e nëpunësve civil			
0	1800	1800	Numri i nëpunësve civil të cilët janë testuar sipas Kornizës Konceptuale për testimin e nëpunësve civilë për vitin 2019 është 1800 nëpunës. Ky

⁸ Shih: MAP, TAKIMI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE PËR REFORMA NË ADMINISTRATEN PUBLIKE, 13 maj 2019, i qasshëm në: <https://map.rks.gov.net/page.aspx?id=2,5,866>.

			treguese është realizuar me sukses, ashtu siç ka qenë i paraparë
Treguesi 1.3.1 Përqindja e nëpunësve civil sipas prejardhjes etnike në shërbimin civil në nivel të administratës qendrore në raport me kriteret e përcaktuara me legjislacion			
9.43%	9.5%	8.92%	Përqindja e nëpunësve civil sipas prejardhjes etnike në shërbimin civil në nivel të administratës qendrore është 8.92% në raport me kriteret e përcaktuara me legjislacionin në fuqi
Treguesi 1.3.2 Koha që kërkohet për rekrutimin e nëpunësve civil (Indikator i SIGMAs 3.3.1, sub 3.)			
Më pak se 90 ditë në 4 nga 5 institucionet e testuara	Më pak se 90 ditë në 4 nga 5 institucionet e testuara	Më pak se 90 ditë në 4 nga 5 institucionet e testuara	Ky tregues matë numrin mesatarë të ditëve kalendarike prej shpalljes së një vendi të lirë deri të publikimi i rezultatit të procesit të përzgjedhja. Gjatë vitit 2019 bazuar në të dhënat të cilat janë pranuar nga 5 institucione koha mesatare që kërkohet për rekrutimin e nëpunësve civil ka qenë 4 deri në 5 institucione, më pak se 90 ditë. Sipas metodologjisë së SIGMA-s vlerësohet me 2 pikë
Treguesi 1.3.3 Numri mesatar i kandidatëve për shpallje (SIGMA 3.3.1, sub 4)			
0 ose 0/4	Së paku 7 kandidatë	5	Përmes këtij treguesi janë analizuar vetëm rekrutimet e hapura për kandidatët e jashtëm duke u përjashtuar rekrutimet në pritje. Të dhënat për këtë tregues janë llogaritur për nivelin qendror, nga 85 institucione që kanë raportuar, ndërsa 17 prej tyre nuk kanë ofruar raport. Sipas metodologjisë së SIGMA-s, vlerësohet me 2 pikë
Treguesi 1.3.4 Efektiviteti i rekrutimit për pozitat e shërbimit civil (%) (SIGMA 3.3.1, sub 5)			
0 ose 0/4	80%	32.64%	Gjatë vitit 2019, në nivel qendror numri i pozitave të shpallura ka qenë 1177, ndërsa numri i pozitave të emëruar është 382
Treguesi 1.3.5 Shkalla e mbajtjes së nëpunësve civilë të sapo punësuar (%) (SIGMA 3.3.1, sub 6)			
Me shumë se 90%	Më shumë se 90%	100%	Gjatë vitit 2019 në kuadër të nivelit qendror prej 5 institucioneve me procedurë të rekrutimit janë pranuar 41 nëpunës civil, ndërsa 0 prej tyre janë vlerësuar me notë negative për vlerësim të performancës. Sipas metodologjisë së SIGMA-s, vlerësohet me 4 pikë
Treguesi 1.3.6 Femra në pozita të larta të shërbimit civil (%) (SIGMA 3.4.1) sub 8			
10%	15%	12.07%	Caku për vitin 2019 ka qenë 10% në pozita të larta në shërbimin civil, të cilat përfshijnë sekretarët e përgjithshëm dhe pozitat e baras-vlefshme. Sipas të dhënave nga gjithsejtë 116 nëpunës të nivelit të lartë, 14 prej tyre janë femra ose 12.07%. Prandaj konstatohet se ky tregues është realizuar me sukses. Sipas metodologjisë së SIGMA vlerësohet me 0 pikë
Treguesi 1.3.7 Stabiliteti i pozitave larta të shërbimit civil (SIGMA 3.4.1 sub 9)			
Më pak se 10%	Më pak se 10%	19.05%	Ky tregues mat stabilitetin e pozitave të larta të SHC, në Administratën Shtetërore në rastet e ndërrimit të Qeverisë si rezultat i zgjedhjeve. Duke u nisur nga fakti që për vitin 2018 baza ka qenë së paku 10%, në vitin 2019 ky tregues ka pasur lëvizje jo të kënaqshme prej 19.05%. Në bazë të të dhënave niveli i pozitave të larta drejtuese nuk ka qenë aq stabil në krahasim me raportin e kaluar. Sipas metodologjisë së SIGMA vlerësohet me 3

			pikë, ndërsa caku sipas planit të SMAP është më pak se 10%
Treguesi 1.4.1 Shpenzimet e trajnimeve në proporcion me nivelin e buxhetit të rrogave vjetore (%) (SIGMA Indicator 3.6.1.sub. ind.12)			
Më pak se 1%	1%		
Treguesi 1.4.2 Pjesëmarrja e nëpunësve civil në trajnime (%) (SIGMA Indicator 3.6.1. sub ind.13)			
22%	31%	17.42%	Buxheti i IKAP i ndarë nga Qeveria për realizimin e shërbimit të trajnimit për vitin 2019 ishte 10,0852.00€. Me buxhetin e ndarë, IKAP ka trajnuar 3224 nëpunës civil apo 17.42% e totalit prej 18500 nëpunës civil, ndërsa realizmi në raport me numrin e nëpunësve civil të përcaktuar për tu trajnuar në PVSMAP 2019 është 56.21% Numri i përgjithshëm i të trajnuarve në IKAP (me buxhet vetanak dhe partnerë) ishte 4548 pjesëmarrës apo 24.58%. Realizmi i indikatorit bazuar në PVSMAP 2019: Realizmi në raport me totalin e nëpunësve civil: 3224/18500=17.42%, dhe realizmi në raport me cakun e përcaktuar: 3224/5735=56.21%. Realizmi i indikatorit bazuar në Planin e punës 2019: Realizmi në raport me totalin e nëpunësve civil: 3400/18500=18.37%, dhe realizmi në raport me cakun e përcaktuar në PP: 3224/3400=94.82%
Objektivi i përgjithshëm II: Shërbime publike administrative janë lehtësisht të qasshme, me qendër përdoruesit, duke përcjellur procedurat administrative të cilat përmirësohen vazhdimisht në bazë të informatave kthyesë të përdoruesve.			
Baza	Treguesi / Objektivi për 2019	Statusi gjatë periudhës së raportimit	Shënim
Treguesi 1. Procedura administrative të drejta dhe efikase (treguesi i SIGMAs 5.2.1)			
2	3		
Treguesi 2. Ekzistenca e mundësive për ofrimin e shërbimeve publike (treguesi 5.3.1)			
1	2		
Treguesi 2.1.1. Së paku 15%, 30% dhe 60% (gjatë 2018, 2019, 2020 v.j.) e procedurave të veçanta administrative të cilat janë në kundërshtim me Ligjin e Procedurës së Përgjithshme Administrative të harmonizuara më të (Indikator i SBS 4.1)			
0%	15%		Në qershor të vitit 2019 ka filluar të punohet një koncept dokument për grupin e dytë të ligjeve të veçanta që përmbajnë procedura të veçanta administrative me qëllim harmonizimi me LPPA. Meqenëse Kryeministri kishte dhënë dorëheqje në korrik 2019, dhe në pamundësi të miratimit të këtij koncept dokumenti nuk ka pasur ndonjë veprim tjetër konkret
Treguesi 2.2.1. Numri i nëpunësve civil të trajnuar për ligjin e procedurës së përgjithshme administrative			
0	1800		
Treguesi 2.3.1. Numri i sistemeve të integruara përmes platformës së interoperabilitetit, baseline 0 nga rreth 70 sisteme që mund të ndërliiden			
0/70	20	10	Gjatë kësaj periudhe janë realizuar këto veprime:

			- Moduli CDS i PI; - Paketa nr. 3 e Regjistrimit Civil për konsumim nga Intraneti i komunave-MAPL; - Pako Push Notifikacion, nga sistemi i inspektimit (AUV) për sistemin ASYCUDA (Dogana e Kosovës); -Upgrade i Sistemit Platforma e Interoperabilitetit (GG)-Lokalizimi; - Web servisi SIKTK-SOJQ; - Gjenerimi i certifikatave dixhitale për autentifikim të sistemeve në PI; - Pako Push Notifikacion, nga sistemi Barnatari (AKPPM) për sistemin ASYCUDA (Dogana e Kosovës) dhe anasjelltas; -Web servisi SIKTK-(AKK) për marrje të të dhënave nga Regjistri Civil, Regjistri i Biznesit dhe Regjistri i OJQ-ve; - moduli për dërgimin automatik të SMS (Bulk SMS); - Web servisi i ATK-së; - 4 web serviseve të Regjistrimit të Pronave-SIKTK (AKK)
Treguesi 2.4.1. Numri i pilot pikave të vetme të kontaktit për më shumë se tri institucione publike të ndryshme			
0	2	0	Themelimi i Qendrës së parë për Shërbim të Qytetarëve - One Stop Shop në Prizren, drejt finalizimit. Janë realizuar të gjitha punimet në renovimin e brendshëm të qendrës, gjithashtu është vendosur edhe inventari. Së shpejti do të vendosen zyrtarët dhe do të fillohet me ofrimin e shërbimeve për qytetar në këtë qendër. Në koordinim me institucionet e nivelit qendror dhe lokal, është përgatitur një listë fillestare e shërbimeve që planifikohen të ofrohen në Pikën e Vetme të Kontaktit në Prizren. Themelimi i Qendrës së parë për Shërbim të Qytetarëve dhe fillimi i ofrimit të shërbimeve është planifikuar në tremujorin e parë të vitit 2020
Treguesi 2.4.2. Numri i shërbimeve të ofruara nga një pilot pikë e kontaktit			
0	15	0	Ky tregues ndërlidhet me atë paraprak 2.4.1. Pra, themelimi i Qendrës së parë për Shërbim të Qytetarëve është drejt finalizimit, janë përzgjedh institucionet që do të ofrojnë shërbime në qendrën e parë si dhe janë përzgjedh shërbimet që do të ofrohen, që planifikohen të jenë mbi 100
Treguesi 2.4.3. Përqindja e shërbimeve që ofrohen përmes portalit E-Kosova			
0	5%	0	ASHI, ka filluar me zhvillimin e Portalit e-Kosova për të ofruar shërbime online për qytetarët. Është hartuar dhe finalizuar koncepti dokumenti për ofrimin e shërbimeve të koncentruar përmes Portalit e-Kosova, janë zhvilluar të gjitha procedurat e prokurimit, është përzgjedhur operatori dhe është nënshkruar kontrata për zhvillimin Portalit e-Kosova. Gjatë vitit 2020, do të zhvillohet dhe funksionalizohet dhe do të fillohet me ofrimin e disa shërbimeve në mënyrë elektronike
Treguesi 2.5.1. Numri i shërbimeve që ju bëhet vlerësimi i kënaqshmërisë së qytetarëve (me përjashtim të E-kutisë)			
20	25	35	Është realizuar anketa, si metodë për marrjen e opinioneve nga qytetarët lidhur me kualitetin dhe qasshmërinë e shërbimeve publike. Numri i institucioneve të përfshira në hulumtim është 18, ndërsa numri i të anketuarve është 5219. Nga zyrtarët anketues janë marrë opinione të

			qytetarëve lidhur me kualitetin dhe qasshmërinë e shërbimeve publike për mbi 200 shërbime që ofrojnë institucionet qendrore dhe ato lokale. Gjithashtu, është finalizuar Raporti i përgjithshëm, dhe raporte të veçanta për çdo njërin institucion ku janë vlerësuar shërbimet
Treguesi 2.6.2. Numri i instrumenteve të ndryshme të përdorura për vlerësimin e kënaqshmërisë së qytetarëve me shërbimet e ofruara nga institucionet (me përjashtim të E-kutisë)			
1	3	1	Instrumenti i përdorur është vetëm Anketa
Objektivi i përgjithshëm III- Administratë publike transparente, të përgjegjshme racionale, me organizim të qartë, racionale dhe me linja të qarta të llogaridhënies mes organeve të administratës publike.			
Baza	Treguesi / Objektivi për 2019	Statusi gjatë periudhës së raportimit	Shënim
Treguesi 1. Llogaridhënia dhe Organizimi i Administratës Publike (Treguesi i SIGMAS)			
1 (Sigma 2017)	3		
Treguesi 2. Qasja në informata publike (Treguesi i SIGMAS)			
3 (Sigma 2017)	4		Që nga hyrja në fuqi e Ligjit Nr.06/L-081 për Qasje në Dokumente Publike më 4 korrik 2019, mbikëqyrja e zbatimit të së drejtës për qasje në dokumente publike i është dhënë si mandat shtesë Agjencisë për Informim dhe Privatësi. Mbikëqyrja efektive e zbatimit të këtij ligji ka filluar nga janari 2020. Institucionet publike këtë vit kanë raportuar në Agjenci lidhur me kërkesat për qasje që kanë pasur gjatë vitit 2019, një obligim ligjor, i cili deri vitin e kaluar koordinohet nga Zyra për Komunikim me Publikun në ZKM
Treguesi 3.1. 1: Miratimi i amendamenteve ligjore për të siguruar që do të shuhet ose integrohen në qeveri së paku 7 agjenci të pavarura që i raportojnë kuvendit. (Indikator i SBS-it)			
0	7	0	Nuk janë miratuar amendamentet në Kuvend. Shkak, vakumi qeveritar
Treguesi 3.1.3. Numri i rregulloreve të miratuara për organizimin të brendshëm të institucioneve në pajtim me LOAP			
0	20%	0	Gjatë vitit 2019 është miratuar pakjo ligjore për AP. Pas miratimit janë themeluar grupet punuese për hartimin e akteve nënligjore të cilat kanë punuar intensivisht në finalizimin e tyre deri në fund të vitit 2019. Për shkak të vakumit qeveritar, aktet nënligjore nuk janë miratuar nga Qeveria, dhe si pasojë nuk ka pasur aprovime të rregulloreve sipas ligjit të ri
Objektivi specifik 3.2. Organizimi më racionale dhe efektiv i administratës publike, me më pak agjenci dhe me linja të qarta të përgjegjësisë mes organeve të administratës publike.			
Treguesi 3.2.1: Së paku 7 agjenci të pavarura që i raportojnë kuvendit shuhet ose integrohen në strukturat e Qeverisë (nga 76 në totali të agjencive ekzistuese). (Indikator i SBS-it)			
0	7	0	Janë përgatitur dy projektligje për bartjen e 8 agjencive nga Kuvendi në Qeveri. Në mungesë të Qeverisë dhe Kuvendit këto projektligje nuk janë miratuar
Treguesi 3.2.2. Së paku 17 agjenci nën varësinë e qeverisë me më pak se 50 të punësuar bashkohen, shuhet ose integrohen në ndonjë strukturë organizative nën hierarkinë e ministrive			
0	10	0	Në qershor të vitit të kaluar në organizim të MAP, të përkrahur nga OECD/SIGMA është mbajtur një takim i nivelit të lartë në mes të përfaqësuesve të BE-së, dhe përfaqësuesve të disa institucioneve të

			Kosovës (MAP, ZKM, MD, MASHT, MTI, MZHE). Në përgjithësi është diskutuar për agjencitë ekzekutive të institucioneve të lartçekura dhe ka pasur një rezistencë të theksuar për të bërë racionalizimin e tyre
Objektivi specifik 3.3. Avancimi i mekanizmave për qasjen në dokumente dhe informacion publik për të siguruar publikimin proaktiv të koordinuar dhe të monitoruar nga niveli qendror për qasje në dokumente dhe informacion publike.			
Treguesi 3.3.1 Përqindja e kërkesave për qasje në dokumente publike të miratuara nga ana e institucioneve publike në baza vjetore			
95%	97%	92.39 %	Aktualisht, AIP është duke mbledhur raporte nga institucionet publike, si punë të trashëguar nga ZKI, dhe ZKM. Ka raste kur institucionet publike raportojnë shifra që nuk kanë rrjedhë logjike të kategorive të kërkesave në raport me totalin e rasteve të raportuara. Bazuar në vitin paraprak (2018) ku baza ka qenë 96 për qind e qasjes së lejuar, dhe në cakun e synuar për vitin 2019, prej 97 për qind të lejimit të qasjes, në bazë të dhënave të mbledhura nga AIP, rezultoi se kemi rënie të numrit të përgjithshëm të numrit të kërkesave për qasje dhe rënie të numrit të lejimit të qasjes
Treguesi 3.3.2. Përqindja e kërkesave të shqyrtuara dhe përgjigjet e kthyer për qasje në dokumente publike brenda afateve ligjore			
98.73%	100%	92.33%	Deri në përmbylljen e hartimit të akteve të brendshme që derivojnë nga LQDP, si rregullorja e brendshme me udhëzuesin e testit të dëmit dhe interesin e publikut, AIP është duke ofruar edhe këshillë dhënie për institucionet publike në trajtimin e kërkesave të qytetarëve në shkallë të parë. Kjo praktikë e përkohshme ka rezultuar në rënien e numrit të ankesave të pritura që të adresoheshin në AIP për trajtim në shkallë të dytë
Treguesi 3.3.3 Përqindja e institucioneve publike që mbajnë webfaqet në pajtim me kërkesat ligjore			
61%	80%	0	Pavarësisht që, sipas LQDP, Agjencia ka mandat të përkujdeset për aspektet përmbajtësore të ëeb faqeve të institucioneve publike, ajo ende nuk ka arritur të veprojë në këtë drejtim në mungesë së titullarit (komisionerit) si dhe në mungesë të personelit të nevojshëm për ta mbikëqyrur edhe këtë segment. Bazuar në këtë, aktualisht nuk mund të ofrohet ndonjë përqindje që do të tregonte se sa institucione publike i përmbahen kritereve të publikimit proaktiv të të dhënave në faqet e tyre zyrtare
Treguesi 3.3.4 Numri i dataseve të publikuara në portalin kombëtar për hapjen e të dhënave			
62	120	195	Në përputhje me rekomandimet e Raportit për Vlerësimin e Gatishmërisë për Hapjen e të Dhënave (ODRA) dhe Kartën për të Dhëna të Hapura, Qeveria e Republikës së Kosovës ka aprovuar vendimin për Organizimin dhe Funksionimin e Strukturave Institucionale për të Dhëna të Hapura. Aktualisht në këtë Portal janë të publikuara 195 datase nga 13 organizata të ndryshme
Treguesi 3.3.5 Përqindja e uljes së numrit të kërkesave për qasje në dokumente publike si rezultat i hapjes së të dhënave			


Vendoset pas raportit vjetor	15%	0	Ende nuk ka arritur të ndërmarrë veprim në lidhje me avancimin e çështjes së proaktivitetit të institucioneve publike për hapjen e të dhënave. Aktivitetet e lidhura me këtë segment priten të ndërmerren nga gjysma e dytë e vitit 2020
------------------------------	-----	---	--

Shërbimi Civil

Sa i përket shërbimit civil, objektiva e përgjithshme e SMAP 2015-2020 është: “Sistem adekuat i avancuar për menaxhimin, monitorimin dhe zbatimin e legjislacionit për shërbimin civil dhe krijimi i mundësisë për një shërbim civil profesional, efikas dhe eficient, zhvillimi i të cilit është e bazuar në parimet e administratës mirë të orientuar kah zbatimi i obligimeve”. Objektivi i përgjithshëm për shërbimin civil në SMAP, përbëhet nga katër (4) objektiva specifike. Për arritjen e këtyre objektivave janë planifikuar gjithsej 19 (nëntëmbëdhjetë) aktivitete, prej tyre janë realizuar vetëm (4) katër aktivitete përgjatë vitit 2019. Ndërkaq, sfidë për realizimin e 15 (pesëmbëdhjetë) aktiviteteve tjera të pazbatuar, mbetet vonesa në miratimin e legjislacionit sekondar për shkak të vakumit politik në vend. Ministria e Punëve të Brendshme dhe Administratës Publike (MPBAP), është përqendruar në politikën e përzgjedhura prioritare për shërbimin civil si: përforsimi i monitorimit të zbatimit të legjislacionit për zyrtarët publike në shërbimin civil si dhe zbatimin e ligjit për pagat e nëpunësve në sektorin publik, dhe sistematizimin e vendeve të punës përmes funksionalizimit të sistemit të ri të pagave.

Sa i përket hartimit dhe miratimit të akteve nënligjore të cilat derivojnë nga ligji i ri për pagat, MAP, ka themeluar grupet punuese për hartimin e akteve nënligjore për zbatim të pakos ligjore për administratën publike. Në këtë drejtim janë hartuar dhe finalizuar aktet nënligjore për zbatimin e Ligjit për paga në sektorin publik si: Rregullore për klasifikimin e vendeve të punës në shërbimin civil; Rregullore për shtesat mbi pagën bazë të nëpunësve publik dhe nëpunësve administrativ dhe mbështetës në sistemin e arsimit para universitar dhe universitar; Rregullore për angazhime shtesë dhe përlogaritjen e pagës dhe përvojës së punës; Rregullore për shtesat mbi pagën bazë për kushte të vështira e të dëmshme të punës, shtesat për punë jashtë orarit të punës dhe shtesat e posaçme për nëpunësit e sistemit shëndetësor; si dhe Rregullore për shtesat mbi pagën bazë të nëpunësve civil dhe nëpunësve të kabineteve dhe kompensimet e zyrtarëve dhe funksionarëve publik.

Po ashtu, edhe tek harmonizimi/plotësimi i Katalogut me pozita të reja në shërbimin civil, është shënuar progres, ku gjatë kësaj periudhe raportuese ka hyrë në fuqi Ligji për zyrtarët publikë (shtator 2019), dhe nuk ka pasur kërkesa nga Institucionet për përditësimin e Katalogut të Vendeve të Punës në SHCK me tituj të ri të punës. Gjatë vitit 2019, Katalogu i vendeve të punës në SHCK është përditësuar me 134 tituj të ri të punës. Si dhe përshkrimi i standardizuar, ku gjatë vitit 2019 gjithsej janë hartuar 106 përshkrime të standardizuara të detyrave të punës për nëpunësit civil. Në anën tjetër, klasifikimi i vendeve të punës sipas ligjit të ri për pagat në AP, janë shënuar disa aktivitete. Në kuadër të grupit të shtatë punues ndërministror, gjatë kësaj periudhe raportuese, ka finalizuar klasifikimin e vendeve të punës në gradat dhe koeficientet përkatës në përputhje me Ligjin për Paga në sektorin publik dhe ka përgatitur me kohë për kalkulim të pagës për muajin dhjetor 2019 për të gjithë të punësuarit (77,565 zyrtar) në sektorin publik sipas sistemit të ri për paga.



Mirëpo, pas vendimit për masë të përkohshme të pezullimit nga Gjykata Kushtetuese, u pezulluan të gjitha punët dhe aktivitetet e grupeve punuese për implementimin e Ligjit për Paga në sektorin publikë. Ndërkaq, aplikimi elektronik në procesin e rekrutimit është ndërprere së zbatuari ashtu siç ka qenë e planifikuar me ligjin për shërbimin civilë, pasi që sipas ligjit për zyrtarët publikë mënyra e aplikimit elektronik ka ndërruar për shkak të ndërrimit të procedurave të rekrutimit. Ky aktivitet do të realizohet sipas projektit të ri për përshtatjen e SIMBNJ-së me pakon ligjore. Në anën tjetër, sukses është shënuar në procesin e integritetit të të dhënave personale të nëpunësve civilë në SIMBNJ. Po ashtu, nga Sistemi i Pagave janë bartur edhe të dhënat e nëpunësve jo civilë. Sa i përket fillimit të aplikimit të modulit të vlerësimit ka ngecje. Kjo nuk është realizuar dhe pritet të realizohet sipas projektit të ri për përshtatjen e SIMBNJ-së me pakon ligjore. Ky aktivitet është ndërprerë për shkak se ligji për zyrtarët publikë ka ndryshime në llojet dhe mënyrën e realizimit të trajnimeve.

Sa i përket krijimit dhe pilotimit të zhvillimit të testimit dhe vlerësimit në formë elektronike për rekrutim në shërbimin civil, kjo nuk është zbatuar për shkak të ndryshimit të legjislacionit dhe mungesës së akteve nënligjore, si dhe mos saktësisht të nëpunësve civilë.

Trajnimi i menaxherëve të personelit dhe zyrtarëve përgjegjës të institucioneve në ndryshimet e reja në legjislacionin e SHCK-së, ka pasur zbatim të pjesërishtëm, për shkak të vonësve në hartimin dhe miratimin e Ligjit për Zyrtarët Publikë dhe rregulloreve të ligjit. Në mungesë të rregulloreve të miratuara, është organizuar një program i kufizuar trajnimi për personelin e njësive të burimeve njerëzore. Gjatë vitit 2019 janë organizuar 7 (shtatë) kurse të trajnimit në të cilat janë trajnuar 257 nëpunës civil. Për trajnimet e mbajtura janë shpenzuar 3888.00 €.

Gjatë vitit 2019, IKAP ka trajnuar 4548 nëpunës civilë në gjithsej 128 kurse trajnimi, me 721 ditë trajnimi. Nëpunësit civilë të trajnuar ishin nga niveli qendror dhe ai lokal i administratës publike. Sipas kategorisë funksionale në shërbimin civil, të trajnuarit ishin 0.29% Menaxher të Lartë, 20.87% Menaxherë, 74.98% Staf Profesional, dhe 3.87% Staf Administrativ. Pjesëmarrja në trajnime sipas gjinisë ishte 48.88% femra dhe 51.12% meshkuj. Buxheti i IKAP-it i ndarë nga Qeveria për zbatimin e shërbimit të trajnimit për vitin 2019 ishte 100,852 €. Me buxhetin e alokuar, IKAP ka trajnuar 3224 nëpunës civilë ose 17,42% të gjithsej 18,500 nëpunësve civilë. Sidoqoftë, si në të kaluarën, buxheti i IKAP për ofrimin, implementimin dhe organizimin e trajnimeve të duhura mbetet i pamjaftueshëm.

Sfidat

- Ndërtimi i sistemit të rekrutimit të centralizuar, sistemit të rekrutimit online, avancimi i SIMBNJ-së për menaxhimin e të gjithë zyrtarëve publikë sidomos integrimi i të dhënave të tyre në sistem, hartimi dhe zbatimi i metodologjisë së re për klasifikimin e vendeve të punës kërkojnë përqendrim të shtuar të kapaciteteve në MPBAP dhe më gjerë si dhe mbështetje dhe vendim-marrje politike;
- Mungesa e legjislacionit sekondar në shërbimin civilë për shkak të vakumit politikë në vend;
- Themelimi i DMZP (ashtu siç parashihet me Ligjin për Zyrtarët Publikë).

Hapat e ardhshëm

- Të miratohet në tërësi Legjislacioni sekondar;
- Përdorimi i plotë i të gjitha moduleve të SIMBNJ-së;
- Integrimi i sistemit të pagave me SIMBNJ (ashtu siç parashihet me Ligjin për Zyrtarët Publikë);
- Si hap i ardhshëm pasi të miratohen rregulloret e trajnimit DASHC dhe IKAP do të hartojnë planin e trajnimit në zbatim të rregulloreve që të do të nxirren në zbatim të Ligjit për Zyrtarët Publikë.

Në përgjithësi ka pasur numër të vogël të zbatimit të aktiviteteve. Krejt kjo për shkakun se shumica e tyre ndërlidhen më zbatimin e Ligjit për Zyrtarët Publikë dhe atë për Pagat. Deri sa ato mbesin të pezulluara deri në një vendim tjetër të Gjykatës Kushtetuese, edhe aktivitetet mbesin të ngrira. Sa i përket realizimit të shumicës së aktiviteteve në tërësi pritet pas miratimit të rregulloreve të Ligjit për Zyrtarët Publikë.

Shërbimet Publike Administrative dhe Procedurat Administrative

Sa i përket Shërbimeve Publike Administrative dhe Procedurave Administrative, objektiva e përgjithshme e SMAP 2015-2020 është: “Shërbimet publike administrative janë lehtësisht të qasshme, me qendër përdoruesit, duke përcjelle procedurat administrative të cilat përmirësohen vazhdimisht në bazë të informatave kthyesë të përdoruesve”. Objektivi i përgjithshëm për Shërbimet Publike Administrative dhe Procedurat Administrative në SMAP, përbëhet nga pesë (5) objektiva specifike. Për arritjen e këtyre objektivave janë planifikuar gjithsej 8 (tetë) aktivitete, prej tyre janë realizuar vetëm (3) tre aktivitete përgjatë vitin 2019, ndërkaq 5 (pesë) aktivitete kanë pasur ngecje. Shërbimet Publike Administrative dhe Procedurat Administrative kanë për qëllim përmirësimin e procedurave administrative dhe modernizimin e shërbimeve publike-administrative të cilat janë përqendruar në politikat prioritare si: vendosja e vizionit dhe politikave të qarta të bazuara në analiza të mirëfillta për modernizimin e shërbimeve publike-administrative, duke zbatuar ligjin e ri të Procedurës së Përgjithshme Administrative. Kjo fushë prioritet ka ngritjen e kapaciteteve për ofrimin e shërbimeve publike-administrative të mira.

Sa i përket hartimit dhe miratimit të grupit të dytë të ligjeve për harmonizim me LPPA, kjo nuk është zbatuar, për shkakun se ligjet nuk kanë mundur të hartohen në mungesë të Koncept Dokumentit. Në kuadër të Platformës së Interoperabilitetit, gjatë kësaj periudhe raportuese janë realizuar një sërë aktiviteteve si: -Është zhvilluar dhe populluar moduli CDS i PI me të dhëna dhe është bërë i mundur konsumimi i tyre nga të gjitha sistemet e integruara në PI; -Është zhvilluar paketa nr. 3 e Regjistrit Civil për konsumim nga Intraneti i komunave-MAPL; -Është zhvilluar pako Push Notifikation (krijimi i web servisit për njoftim automatik të çdo ndryshimi në sistemin primar) nga sistemi i inspektimit (AUV) për sistemin ASYCUDA (Dogana e Kosovës); -Është bërë-Upgrade i Sistemit Platforma e Interoperabilitetit (GG)- Lokalizimi; -Është krijuar ëeb servisi SIKTK- SOJQ; -Është aktivizuar gjenerimi i certifikatave dixhitale për autentifikim të sistemeve në PI; -Është përfunduar analiza e zhvillimit të modulit të pagesave elektronike dhe njoftimeve për pagesa; -Është zhvilluar web servisi i ATK-së, përmes të cilit njoftohet Regjistri i Automjeteve për bllokimin të veturës, nëse biznesi ka borxhe ndaj ATK; si dhe -Janë zhvilluar 4 web serviseve të Regjistrit të Pronave-SIKTK (AKK) dhe janë të gatshme për konsumim nga institucionet, etj. Për realizimin e aktiviteteve të lartpërmendura janë shpenzuar 295.841 euro. Gjatë

vitit 2020, pritet të integrohen në Platformën e Ndërveprimit edhe sisteme tjera elektronike të institucioneve, konform dinamikës dhe afateve të parashikuara.

Viti 2019, gjithashtu shënoi një përparim të rëndësishëm në përmirësimin e ofrimit të shërbimeve për qytetarët dhe komunitetin e biznesit, me një pilot projekt, që filloi në Prizren, për ndërtimin e një adrese të vetme (one stop shop) për qasje në shërbimet publike. Në këtë kuadër, janë realizuar të gjitha punimet në renovimin e brendshëm të ndërtesës së qendrës, gjithashtu, është vendosur edhe inventari i brendshëm. Së shpejti do të vendosen zyrtarët dhe do të fillohet me ofrimin e shërbimeve për qytetar në këtë One Stop Shop. Në koordinim me institucionet e nivelit qendror dhe lokal, është përgatitur një listë fillestare e shërbimeve që planifikohen të ofrohen në Pikën e Vetme të Kontaktit- OSSH, në Prizren.

Sa i përket zhvillimit dhe funksionalizimit të Portalit e-Kosova, për të ofruar shërbime online për qytetarët (Pika e Vetme e Kontaktit), është filluar me zhvillimin e tij. Portali e-Kosova është sportel elektronik, nëpërmjet të cilit çdo person i interesuar mund të marrë nëpërmjet internetit shërbime elektronike nga institucionet, duke shkurtuar distancën, rritur efikasitetin dhe shpejtësinë e marrjes së shërbimit. Në këtë kuadër është hartuar dhe finalizuar koncept dokumenti për ofrimin e shërbimeve të koncentruar përmes Portalit, e-Kosova, janë zhvilluar të gjitha procedurat e prokurimit, është përzgjedhur dhe nënshkruar kontrata me operatorin për zhvillimin Portalit. Ky projekt është tre vjeçar, ndërsa vlera financiare është 2,976,509.00€.

Njëherit, gjatë viti 2020, do të zhvillohet dhe funksionalizohet Portali e-Kosova dhe do të fillohet me ofrimin e disa shërbimeve në mënyrë elektronike.

Edhe në kaudrin e matjes së opinionit publik është zhvilluar një veprim konkret. Është realizuar anketa, si metodë për marrjen e opinioneve nga qytetarët lidhur me kualitetin dhe qasshmërinë e shërbimeve publike. Numri i institucioneve të përfshira në hulumtim është 18, ndërsa numri i të anketuarve është 5219. Anketa është realizuar në: Ministrinë e Punëve të Brendshme (Agjencinë e Regjistrimit Civil dhe Policinë e Kosovës); Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë (Agjencia për Regjistrimin e Bizneseve); Ministrinë e Administratës Publike (shërbimet për OJQ); Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë; Ministrinë e Financave (ATK), ndërsa në nivelin lokal janë vlerësuar shërbimet në Komunën e Prizrenit, Prishtinës, Shtimes, Ferizajt, Gjilanit, Kamenicës dhe Fushë Kosovës. Nga zyrtarët anketues janë marr opinione të qytetarëve lidhur me kualitetin dhe qasshmërinë e shërbimeve publike për mbi 200 shërbime që ofrojnë këto institucione. Gjithashtu, është finalizuar raporti i përgjithshëm dhe raporte të veçanta për çdo njërin institucion ku janë vlerësuar shërbimet. Sa i përket anës financiare për këtë aktivitet janë shpenzuar rreth 12,000.00€.

5,219	24	E-Kosova
<ul style="list-style-type: none"> • 5,219 të anketuar u përfshinë në sondazhin mbi kënaqshmërinë e qytetarëve me cilësinë dhe aksesin e shërbimeve publike për më shumë se 200 shërbime. 	<ul style="list-style-type: none"> • 24 shërbime elektronike të institucioneve, që ofrojnë pesëdhjetë (50) lloje të transaksioneve janë integruar deri më tani në Platformën e Ndërveprimit (Government Gateway). 	<ul style="list-style-type: none"> • Të gjitha procedurat e prokurimit u zhvilluan dhe u zgjodh operatori, si dhe u nënshkrua kontrata për zhvillimin e Portalit. Ky projekt është një projekt tre vjeçar me një vlerë financiare prej 2,976,509.00 €.

Sfidat

- Harmonizimi i legjislacionit specifik me LPPA;
- Ofrimi i një qasje më të mirë të shërbimeve sidomos dinamika e deritashme e zbatimit të aktiviteteve që lidhen me pilot pikat e vetme të kontaktit dhe portalit e-Kosova me gjithë progresin e arritur deri më tash, shihet së do të shkaktojë vonesa apo mungesë të realizimit të të gjitha aktiviteteve në këtë fushë;
- Themelimi i strukturës përgjegjëse për shërbimet publike administrative. Një strukturë e tillë është parakusht për një koordinim më të mirë të ofrimit të shërbimeve publike administrative; si dhe
- Megjithëse ka pasur progres, caku i numrit të të trajnuarve prej 800 zyrtarëve për LPPA, sipas dinamikës së punës gjatë gjashtë muorit të parë, ku janë trajnuar vetëm 209 zyrtarë do të jetë e vështirë për tu arritur deri në fund të vitit 2019.

Hapat e ardhshëm

- Informimi i vazhdueshëm i qytetarëve për të drejtat dhe mënyrat e realizimit të tyre, për mënyrat e marrjes së shërbimeve publike-administrative, mënyrat e regjistrimit dhe çështjet tjera që mund të jenë me interes për ata;
- Po ashtu, do të krijohen mekanizmat për matjen e opinionit për kualitetin e shërbimeve publike-administrative nga ana e organeve publike dhe organizatave tjera në nivel lokal dhe qendror;
- Do të krijohen mekanizmat për të udhëhequr, planifikuar, monitoruar dhe vlerësuar cilësinë e shërbimeve publike-administrative dhe zbatimin e ligjit të procedurës së përgjithshme administrative.

Llogaridhënja dhe Organizimi i Administratës Shtetërore


Sa i përket Llogaridhënies dhe Organizimin të Administratës Shtetërore, objektiva e përgjithshme e SMAP 2015-2020 është: “Administratë publike transparente, të përgjegjshme racionale, me organizim të qartë, racional dhe me linja të qarta të llogaridhënies mes organeve të administratës publike”. Objektivi i përgjithshëm për Llogaridhënien dhe Organizimin e Administratës Shtetërore, në SMAP,

përbëhet nga katër (4) objektiva specifike. Për arritjen e këtyre objektivave janë planifikuar gjithsej 13 (trembëdhjetë) aktivitete, prej tyre janë realizuar 5 (pesë) aktivitete, ndërsa 8 (tetë) aktivitete kanë pasur ngecje. Kjo fushë përqendrohet në: finalizimin e kornizës së nevojshme ligjore për organizimin e administratës publike. MPBAP, ka për qëllim të fuqizojë mekanizmat për monitorimin e zbatimit të ligjit për organizimin e administratës dhe fuqizimin në mbikëqyrjen e zbatimit të ligjit për qasjen në dokumentet publike duke vendosur rregulla të cilat detyrojnë institucionet për zbatimin e tij.

Sa i përket hartimit dhe miratimit të Rregullores për standardet e organizimit të brendshëm dhe sistematizimit të vendeve të punës, MAP, ka themeluar grupet punuese për hartimin e akteve nënligjore për zbatim të pakos ligjore për administratën publike. Grupet punuese kanë punuar intensivisht në hartimin e akteve nënligjore deri në finalizimin e tyre, ku janë zhvilluar edhe konsultimet paraprake para dërgimit të tyre për aprovim në Qeveri. Më 22 janar 2020, Qeveria me vendim nr. 05/117 ka miratuar Rregulloren për Standardet e Organizimit të Brendshëm, Sistematizimin e Vendeve të Punës dhe Bashkëpunimin me Institucionet e Administratës Shtetërore dhe Agjencitë e Pavarura, si dhe më 29 janar 2020, me vendim nr. 09/118 ka miratuar Rregulloren për Performancën e Agjencive. *Mirëpo, edhe ky aktivitet si shumë të tjera pritet të realizohet pas formimit të Qeverisë (Qeveria është votuar më 03 shkurt 2020), dhe kjo pritet të ndodh pas ndryshimeve masive organizative të institucioneve. Krejt kjo pritet dhe do të duhej të riorganizohet sipas pakos së re ligjore.*

Edhe në kuadrin e rishikimit të rregulloreve për Organizim të Brendshëm të institucioneve të RKS, ndërlihen me zbatimin e pakos ligjore, rrjedhimisht me vendimin e Gjykatës Kushtetuese për pezullim. Aktet nënligjore për zbatimin e Ligjit për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura janë miratuar në janar të vitit 2020. Edhe ky aktivitet pritet të bëhet pas formimit të kabinetit të ri qeveritar, dhe ndryshimeve organizative të institucioneve. Sa i përket hartimit dhe miratimit të planit të veprimit për racionalizimin e agjencive, ky aktivitet është zbatuar nëse flasim për përgjegjësit dhe angazhimin e institucioneve zbatuese, në kaudrin e obligimeve dhe detyrave të punës. Obligime këto që derivojnë nga pakoja ligjore. Me ç'rast, janë përgatitur dy projektligje për bartjen e 8 agjencive nga Kuvendi në Qeveri, mirëpo në mungesë të Qeverisë dhe Kuvendit si pasojë e zgjedhjeve të parakohshme, këto projektligje nuk kanë mundur të miratohen.

Edhe tek shqyrtimi i agjencive, janë ndërmarrë disa aktivitete. Aktivitetet kishin të bënin me valën e dytë të racionalizimit të agjencive. Në qershor të vitit të kaluar në organizim të MAP, dhe të përkrahur nga OECD/SIGMA, është mbajtur një takim i nivelit të lartë në mes të përfaqësuesve të Bashkimit Evropian dhe përfaqësuesve të disa institucioneve të Kosovës (MAP, ZKM, MD, MASHT, MTI, MZHE). Në përgjithësi është diskutuar për agjencitë ekzekutive të institucioneve të lartcekura dhe ka pasur një rezistencë të theksuar për bërë racionalizimin e tyre.



Po ashtu, gjatë vitit 2019 është publikuar Raporti i Vlerësimit të Gatishmërisë për Hapjen e të Dhënave – ODRA. Ky raport ka një bazë solide për zhvillimin e një iniciative efektive për hapjen e të dhënave. Raporti përmban një Plan të Veprimit Kombëtar për hapjen e të dhënave, në mesin e aktiviteteve që parashihen me këtë plan të veprimit është edhe krijimi i kornizës së nevojshme institucionale për zbatimin e politikave për hapjen e të dhënave në Kosovë. Në përputhje me rekomandimet e Raportit për Vlerësimin e Gatishmërisë për Hapjen e të Dhënave – ODRA, dhe Kartën për të Dhëna të Hapura, Qeveria e Republikës së Kosovës ka aprovuar vendimin për Organizimin dhe Funksionimin e Strukturave Institucionale për të Dhëna të Hapura. Aktualisht në këtë Portal janë të publikuara 195 datasete nga 13 organizata të ndryshme. Sipas Vendimit mekanizma institucional për të dhëna të hapura janë: Grupi Drejtues për të Dhëna të Hapura; Koordinatorin për të Dhëna të Hapura; Zyrtarët ndërlidhës për të dhëna të hapura; si dhe Grupi Punues i Qeverisë për të Dhënat e Hapura dhe Njësia/ sektori për të Dhëna të Hapura. *Si hap i ardhshëm i planifikuar është publikimi dhe popullimi në numër sa më madh të data seteve, në Portalin Shtetëror për të Dhënat e Hapura. Publikimi dhe popullimi i data seteve, në Portalin Shtetëror për të Dhënat e Hapura është i vazhdueshëm.*

Sfidat

- Zbatimi i ligjit për organizimin e administratës shtetërore;
- Zbatimi i planit për racionalizimin e agjencive ekzekutive dhe atyre të pavarura paraqet sfidën kryesore gjatë periudhës së ardhme;
- Një çështje që shënohen ngecje është edhe themelimi i bazës ligjore dhe zbatimi i saj për përgjegjësinë kontraktuale të administratës publike. Megjithëse, ka ende kohë për adresimin e kësaj çështje, dinamika e zbatimit të aktiviteteve që lidhen me këtë objektiv kërkon shtimin e vëmendjes dhe aktiviteteve nëse synohet të realizohet deri në fund të zbatimit të planit për SMAP.

Hapat e ardhshëm

- Pro aktiviteti i organeve publike kuptimin që informatat të cilat janë me interes për publikun vendosen në ueb-faqet e tyre zyrtare, ndërsa përditësimi dhe mbikëqyrja e tyre bëhet rregullisht;
- Politika të qarta dhe sigurimi i mekanizmave për kompensim në rastet kur autoritetet publike gjatë marrjes së vendimeve ose me veprimet apo mosveprimet e tyre shkaktojnë dëme;
- Ri organizimi i Institucioneve të Administratës Shtetërore sipas pakos së re ligjore.

Tabela 2: Procesi i zbatimit të reformave në nivel të aktiviteve

Shërbimi Civil				
Objektiva e përgjithshme 1:		Sistem adekuat i avancuar për menaxhimin, monitorimin dhe zbatimin e legjislacionit për shërbimin civil dhe krijimi i mundësisë për një shërbim civil profesional, efikas dhe eficient zhvillimi i të cilit është e bazuar në parimet e administratës së mirë dhe të orientuar kah zbatimi i obligimeve.		
Objektiva specifike 1.1		1.1. Zbatimi i sistemit të ri të pagave për nëpunësit civil që bazohet në Katalogun e vendeve të punës dhe klasifikimin e vendeve të punës, të jetë i drejtë dhe transparent dhe të bazohet në parimin pagë e njëjtë për punën e njëjtë		
Nr.	Aktivitetet	Gjendja	Institucioni	Sqarim i shkurtër mbi progresin
1.1.2	Hartimi dhe miratimi i akteve nënligjore i cili derivon nga ligji i ri për pagat.	Jo e zbatuar	DL/ DASHC	MAP, ka themeluar grupet punuese për hartimin e akteve nënligjore për zbatim të pakos ligjore për administratën publike. Janë hartuar dhe finalizuar aktet nënligjore për zbatimin e Ligjit për Paga në sektorin publik. Gjithsejtë janë 5 Rregullore
1.1.3	Harmonizimi/ plotësimi i Katalogut me pozita të reja në shërbimin civil.	Jo e zbatuar	DASHC	Gjatë kësaj periudhe raportuese ka hyrë në fuqi Ligji për Zyrtarët publik (shtator 2019) dhe nuk ka pasur kërkesa nga Institucionet për përditësimin e Katalogut të Vendeve të Punës në SHCK me tituj të ri të punës. Gjatë vitit 2019 Katalogu i vendeve të punës në SHCK është përditësuar me 134 tituj të ri të punës
1.1.4	Hartimi i Metodologjisë (Udhëzues) për Standardizimin e përshkrimeve të vendeve të punës sipas katalogut.	Jo e zbatuar	DASHC	
1.1.5	Përshkrimet e standardizuara të detyrave të punës sipas pozitave të katalog në shërbimin civil dhe Metodologjisë/ Udhëzuesit.	Jo e zbatuar	DASHC	Gjatë vitit 2019 gjithsejtë janë hartuar 106 përshkrime të standardizuara të detyrave të punës për nëpunësit civil
1.1.6	Publikimi i pagave për të gjitha pozitat e shërbimit civil (aktuale dhe sipas katalogut)	Jo e zbatuar	DASHC	
1.1.7	Klasifikimi i vendeve të punës sipas ligjit të ri për pagat në AP.	E zbatuar	DASHC	Grupi punues ka finalizuar klasifikimin e vendeve të punës në gradat dhe koeficientet përkatës në përputhje me Ligjin për Paga në sektorin publik dhe përgatiti me kohë për kalkulim të pagës për muajin dhjetor 2019 për të gjithë të punësuarit (77.565 zyrtar) në sektorin publik sipas sistemit të ri për paga. Pas vendimit për masë të përkohshme të Gjykatës Kushtetuese u pezulluan të gjitha punët dhe aktivitetet e grupeve punuese për implementimin e Ligjit për Paga në sektorin publik
Objektiva specifike 1.2		O.S 1.2 Menaxhimi i burimeve njerëzore përmes SIMBNJ-ës nga të gjitha institucionet dhe monitorimi i zbatimit të legjislacionit për shërbimin civil. Politikat dhe vendimet për burimet njerëzore në nivel qendror dhe lokal janë përmirësuar si rezultat udhëzimeve dhe analizave strategjike të nxjerra nga niveli qendror.		
Nr.	Aktivitetet	Gjendja	Institucioni	Sqarim i shkurtër mbi progresin
1.2.1	Hartimi dhe miratimi i akteve nënligjore dhe përgatitja e	Jo e zbatuar	DASHC	Rregulloret për pranim në shërbimin civil janë draftuar por nuk janë miratuar për

	udhëzuesve për aplikimin e sistemit të ri të rekrutimit për nëpunësit civil.			shkak të pezullimit të ligjit për zyrtarët publik
1.2.2	Zbatimi i aplikimit online në procesin e rekrutimit të nëpunësve civil.	<i>Jo zbatuar</i>	<i>e DASHC</i>	Aktiviteti i aplikimit elektronik në procesin e rekrutimit është ndërprerë së zbatuari ashtu siç ka qenë e planifikuar me ligjin për shërbimin civil, pasi që sipas ligjit për zyrtarët publik mënyra e aplikimit elektronik ka ndërruar për shkak të ndërrimit të procedurave të rekrutimit. Ky aktivitet do të realizohet sipas projektit të ri për përshtatjen e SIMBNJ-së me pakon ligjore
1.2.3	Integrimi i të dhënave personale dhe të punësimit të nëpunësve civil në formë elektronike nga dosjet fizike në SIMBNJ, nga të gjitha institucionet.	<i>E zbatuar</i>	<i>DASHC</i>	Procesi i integrit të dhënave personale të nëpunësve civil në SIMBNJ është përfunduar. Po ashtu, nga Sistemi i Pagave janë bartur edhe të dhënat e nëpunësve jo civil
1.2.4	Krijimi dhe vendosja e modulit sipas sistemit të ri të vlerësimit.	<i>Jo zbatuar</i>	<i>e DASHC</i>	Fillimi i aplikimit të modulit të vlerësimit nuk është realizuar dhe pritet të realizohet sipas projektit të ri për përshtatjen e SIMBNJ-së me pakon ligjore
1.2.5	Zhvillimi dhe aplikimi i modulit të trajnimeve në SIMBNJ.	<i>Jo zbatuar</i>	<i>e DASHC/IKAP</i>	Aktiviteti i zhvillimit dhe aplikimi i modulit të trajnimeve në SIMBNJ është ndërprerë për shkak se ligji për zyrtarët publik ka ndryshime në llojet dhe mënyrën e realizimit të trajnimeve. Ky aktivitet do të realizohet sipas projektit të ri për përshtatjen e SIMBNJ-së me pakon ligjore
1.2.8	Hartimi i kornizës konceptuale për të matur standardin e nevojshëm/ testimin e NC sipas fushave të përgjithshme të nivelit profesional.	<i>Jo zbatuar</i>	<i>e DASHC</i>	Ndryshimi i legjislacionit dhe mungesa e akteve nënligjore dhe mos saktësimi i nëpunësve civil, andaj nuk është marrë ndonjë aktivitet
1.2.9	Pilotimi i Testimit sipas Kornizës konceptuale për testimin e nëpunësve civil.	<i>Jo zbatuar</i>	<i>e DASHC</i>	Njëjtë sikurse Aktiviteti më lartë 1.2.9. Për arsye të ndryshimit të legjislacionit
1.2.10	Publikimi i raportit vjetor për masat disiplinore që ndërmerren kundër nëpunësve civil për shkeljet e etikes dhe antikurpsionit (nga SBS).	<i>E zbatuar</i>	<i>DASHC</i>	Janë mbledhur të dhënat nga institucionet dhe është bërë publikimi i raportit
Objektiva specifike		O.S. 1.3. Organizimi dhe funksionimi i shërbimit civil profesional dhe te bazuar në meritë.		
Nr.	Aktivitetet	Gjendja	Institucioni	Sqarim i shkurtër mbi progresin
1.3.2	Hartimi dhe miratimi i akteve nënligjore sipas Ligjit të ri për Zyrtarët Publik.	<i>Jo zbatuar</i>	<i>e DASHC</i>	Deri tani janë të përfunduara 15 Projekt Rregullore. Të gjitha këto projekt rregullore pritet të aprovohen nga Qeveria
1.3.4	Krijimi dhe pilotimi i zhvillimit të testimit dhe vlerësimit në formë elektronike për rekrutim në shërbimin civil.	<i>Jo zbatuar</i>	<i>e DASHC</i>	Ndryshimi i legjislacionit dhe mungesa e akteve nënligjore dhe mos saktësimi i nëpunësve civil, andaj nuk është marrë ndonjë aktivitet
1.3.5	Fillimi i zbatimit të rekrutimit sipas sistemit të ri në nivelin qendror të institucioneve të administratës shtetërore.	<i>Jo zbatuar</i>	<i>e DASHC</i>	Edhe ky aktivitet nuk është zbatuar. Arsye, pezullimi i Ligjit për Zyrtarët Publik nga Gjykata Kushtetuese

1.3.6	Trajnimi i menaxherëve të personelit dhe zyrtarëve përgjegjës të institucioneve në ndryshimet e reja në legjislacionin e SHCK-së (Menaxheri i personelit dhe një zyrtar).	<i>Jo e zbatuar</i>	IKAP	Ky aktivitet ka pasur një zbatim të pjesërishëm për shkak të vonesave në hartimin dhe miratimin e Ligjit për Zyrtarët Publik dhe rregulloreve të ligjit. Në mungesë të rregulloreve të miratuara, ka organizuar një program të kufizuar trajnimi për personelin e njësive të burimeve njerëzore. Gjatë këtij viti janë organizuar 7(shtatë) kurse të trajnimit në të cilat janë trajnuar 257 nëpunës civil. Për trajnimet e mbajtura janë shpenzuar 3888.00 €. Si hap i ardhshëm pasi të miratohen rregulloret e trajnimit, DASHC dhe IKAP, do të hartojnë planin e trajnimit në zbatim të rregulloreve që të do të nxirren në zbatim të Ligjit për Zyrtarët Publik. Ky aktivitet në tërësi pritet të realizohet pas miratimit të rregulloreve të ligjit për zyrtarët publik
Objektiva specifike		O.S 1.4. Ofrimi i trajnimeve për nëpunësit civil për ngritjen e kapaciteteve nga një institucion qendror i trajnimeve.		
1.4.2	Hartimi i kurrikulës për trajnimet për nëpunësit civil me strategjinë e trajnimit.	<i>E zbatuar</i>	IKAP	Ky aktivitet ka filluar në dhjetorit të vitit 2018, dhe është e pjesë e pakos për vlerësimin e nevojave për trajnim dhe hartimin e planit të veprimit të strategjisë së trajnimit për vitet (2019-2020)
Shërbimet Publike Administrative dhe Procedurat Administrative				
Objektiva e përgjithshme 2:		Shërbime publike administrative janë lehtësisht të qasshme, me qendër përdoruesit, duke përcjellur procedurat administrative të cilat përmirësohen vazhdimisht në bazë të informatave kthyesë të përdoruesve.		
Objektiva specifike 2.1		Është krijuar kornizë ligjore koherente dhe konsistente për procedurat administrative dhe procedurat për shërbime publike administrative në pajtim me ligjin e ri.		
Nr.	Aktivitetet	Gjendja	Institucioni	Sqarim i shkurtër mbi progresin
2.1.5	Hartimi dhe miratimi i grupit të dytë të ligjeve për harmonizim me LPPA.	<i>Jo e zbatuar</i>	DL	Ligjet nuk kanë mundur të hartohen në mungesë të Koncept Dokumentit
2.1.6	Hartimi dhe miratimi i koncept dokumentit për grupin e tretë të ligjeve për harmonizim me LPPA.	<i>Jo e zbatuar</i>	DL	Nuk është miratuar Koncept Dokumenti për gupin e tretë të ligjeve për harmonizim me LPPA
Objektiva specifike 2.2		Mekanizma institucional dhe kapacitetet e ngritura për udhëheqjen, planifikimin, monitorimin, vlerësimin dhe zbatimin e shërbimeve publike-administrative.		
Nr.	Aktivitetet	Gjendja	Institucioni	Sqarim i shkurtër mbi progresin
2.2.3	Themelimi i strukturës përgjegjëse për shërbimet publike administrative.	<i>Jo e zbatuar</i>	MAP	Ende nuk është themeluar kjo strukturë
2.2.6	Trajnimi i nëpunësve civil për LPPA.	<i>Jo e zbatuar</i>	IKAP	
Objektiva specifike 2.3		Ndërtimi dhe integrimi sistemeve elektronike në mënyrë progresive duke u bazuar në kornizën e interoperabilitetit.		
Nr.	Aktivitetet	Gjendja	Institucioni	Sqarim i shkurtër mbi progresin
2.3.1	Integrimi i 40 sistemeve elektronike përmes platformës së			Gjatë kësaj periudhe janë realizuar këto aktivitete: - Moduli CDS i PI; - Paketa nr. 3 e Regjistrat Civil për konsumim nga Intraneti i komunave-MAPL; -

	interoperabilitetit deri në vitin 2020	<i>E zbatuar</i>	<i>ASHI</i>	Pako Push Notifikacion, nga sistemi i inspektimit (AUV) për sistemin ASYCUDA (Dogana e Kosovës); -Upgrade i Sistemit Platforma e Interoperabilitetit (GG)-Lokalizimi; - Web servisi SIKTK-SOJQ; - Gjenerimi i certifikatave dixhitale për autentifikim të sistemeve në PI; - Pako Push Notifikacion, nga sistemi Barnatari (AKPPM) për sistemin ASYCUDA (Dogana e Kosovës) dhe anasjelltas; -Web servisi SIKTK-(AKK) për marrje të të dhënave nga Regjistri Civil, Regjistri i Biznesit dhe Regjistri i OJQ-ve; - moduli për dërgimin automatik të SMS (Bulk SMS); - Web servisi i ATK-së; - 4 web serviseve të Regjistrimit të Pronave-SIKTK (AKK). Gjatë vitit 2020 pritet të integrohen në PI, edhe sisteme elektronike të tjera të institucioneve, konform dinamikës dhe afateve të parashikuara. Integrimi i 40 sistemeve elektronike nëpërmjet PI, pritet të realizohet konform afateve të parashikuara
Objektiva specifike 2.4		Ofrimi i shërbimeve për qytetarë përmes pilotimit të pikave të vetme të kontaktit.		
Nr.	Aktivitetet	Gjendja	Institucioni	Sqarim i shkurtër mbi progresin
2.4.3	Themelimi i dy pilot pikave të vetme të kontaktit për më shumë se tri shërbime publike të ndryshme.	<i>Jo e zbatuar</i>	<i>MAP</i>	Themelimi i Qendrës së parë për Shërbim të Qytetarëve - One Stop Shop në Prizren, drejt finalizimit. Janë realizuar të gjitha punimet në renovimin e brendshëm të qendrës, gjithashtu është vendosur edhe inventari. Së shpejti do të vendosen zyrtarët dhe do të fillohet me ofrimin e shërbimeve për qytetar në këtë qendër. Në koordinim me institucionet e nivelit qendror dhe lokal, është përgatitur një listë fillestare e shërbimeve që planifikohen të ofrohen në Pikën e Vetme të Kontaktit në Prizren. Themelimi i Qendrës së parë për Shërbim të Qytetarëve dhe fillimi i ofrimit të shërbimeve është planifikuar në tremujorin e parë të vitit 2020. Projekti i zhvillimit dhe funksionalizimit të Portalit e-Kosova është tre vjeçar, ndërsa vlera financiare e këtij projekti është 2,976,509.00€
2.4.4	Zhvillimi dhe funksionalizimi i Portalit e-Kosova për të ofruar shërbime online për qytetarët (Pika e Vetme e Kontaktit)	<i>E zbatuar</i>	<i>ASHI</i>	ASHI, ka filluar me zhvillimin e Portalit e-Kosova për të ofruar shërbime online për qytetarët. Është hartuar dhe finalizuar koncepti i dokumentit për ofrimin e shërbimeve të koncentruar përmes Portalit e-Kosova, janë zhvilluar të gjitha procedurat e prokurimit, është përzgjedhur operatori dhe është nënshkruar kontrata për zhvillimin e Portalit e-Kosova. Gjatë vitit 2020, do të zhvillohet dhe funksionalizohet dhe do të fillohet me ofrimin e disa shërbimeve në mënyrë elektronike. Projekti i zhvillimit dhe funksionalizimit të Portalit e-Kosova është tre vjeçar, ndërsa vlera financiare e këtij projekti është 2,976,509.00€
Objektiva specifike 2.5		Përcaktimi i mekanizmave dhe instrumenteve për matjen e opinionit publik për kualitetin dhe qasshmërinë e shërbimeve publike (përveq e-kutisë).		
Nr.	Aktivitetet	Gjendja	Institucioni	Sqarim i shkurtër mbi progresin

2.5.2	Në përputhje me rekomandimet e udhëzuesit, përcaktimi i instrumenteve për matjen e opinionit publik për kualitetin dhe qasshmërinë e shërbimeve publike	E zbatuar	MAP	Është realizuar anketa, si metodë për marrjen e opinionëve nga qytetarët lidhur me kualitetin dhe qasshmërinë e shërbimeve publike. Numri i institucioneve të përfshira në hulumtim është 18, ndërsa numri i të anketuarve është 5219. Nga zyrtarët anketues janë marrë opinione të qytetarëve lidhur me kualitetin dhe qasshmërinë e shërbimeve publike për mbi 200 shërbime që ofrojnë institucionet qendrore dhe ato lokale. Gjithashtu, është finalizuar Raporti i përgjithshëm, dhe raporte të veçanta për çdo njërin institucion ku janë vlerësuar shërbimet, ndërsa gjatë tremujorit të parë të vitit 2020, do të publikohen rezultatet e anketës. Për realizimin e anketës janë shpenzuar rreth 12,000.00€
Llogaridhënja dhe Organizimi i Administratës Shtetërore				
Objektiva e përgjithshme 3:		Administratë publike transparente, të përgjegjshme racionale, me organizim të qartë, racional dhe me linja të qarta të llogaridhënies mes organeve të administratës publike.		
Objektiva specifike 3.1		Kompletimi i kornizës ligjore për organizimin e AP.		
Nr.	Aktivitetet	Gjendja	Institucioni	Sqarim i shkurtër mbi progresin
3.1.2	Hartimi dhe miratimi i Rregullorës për standardet e organizimit të brendshëm dhe sistematizimit të vendeve të punës.	E zbatuar	DRAPIE	MAP, ka themeluar grupet punuese për hartimin e akteve nënligjore. Grupet punuese kanë punuar intensivisht në hartimin e aktave nënligjore deri në finalizimin e tyre, ku janë zhvilluar edhe konsultimet paraprake para dërgimit të tyre për aprovim në Qeveri. Më 22 janar 2020, Qeveria me vendim nr. 05/117 ka miratuar Rregulloren për Standardet e Organizimit të Brendshëm, Sistematizimin e Vendeve të Punës dhe Bashkëpunimin me Institucionet e Administratës Shtetërore dhe Agjencitë e Pavarura, si dhe më 29 janar 2020, me vendim nr. 09/118 ka miratuar Rregulloren për Performancën e Agjencie. Pas formimit të kabinetit të ri qeveritar, dhe ndryshimeve organizative të institucioneve, pritet riorganizimi sipas pakos së re ligjore
3.1.4	Rishikimi i rregulloreve për Organizim të Brendshëm të institucioneve të RKS.	Jo e zbatuar	DRAPIE	Aktet nënligjore për zbatimin e Ligjit për Organizimin dhe Funkcionimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencie të Pavarura janë miratuar në janar 2020. Pas formimit të kabinetit të ri qeveritar, dhe ndryshimeve organizative të institucioneve, pritet riorganizimi sipas pakos së re ligjore
Objektiva specifike 3.2		Organizimi më racional dhe efektiv i administratës publike, me më pak agjenci dhe me linja të qarta të përgjegjësisë mes organeve të administratës publike.		
Nr.	Aktivitetet	Gjendja	Institucioni	
3.2.1	Hartimi dhe miratimi i planit të veprimit për racionalizimin e agjencie qeveritare qendrore dhe agjencie të pavarura.	E zbatuar	DRAPIE	Janë përgatitur dy projektligje për bartjen e 8 agjencie nga Kuvendi në Qeveri. Në mungesë të Qeverisë dhe Kuvendit këto projektligje nuk kanë mundur të miratohen
3.2.2	Shqyrtimi i agjencie bazuar në Planin e Veprimit të miratuar për racionalizimin e agjencie qeveritare qendrore.	Jo e zbatuar	KMRAP, SEKRETARI ATI	Disa aktivitete janë ndërmarrë sa i përket valës së dytë të racionalizimit të agjencie. Në qershor të vitit të kaluar në organizim të MAP, të përkrahur nga OECD/ SIGMA është mbajtur një takim i nivelit të lartë në mes të

				përfaqësuesve të BE-së dhe përfaqësuesve të disa institucioneve të Kosovës (MAP, ZKM, MD, MASHT, MTI, MZHE). Në përgjithësi është diskutuar për agjencitë ekzekutive të institucioneve të lartcekura dhe ka pasur një rezistencë të theksuar për të bërë racionalizimin e tyre
3.2.3	Mbështetja e zbatimit të rishikimeve për racionalizimin e agjencive qeveritare qendrore sipas Planit të Veprimit dhe Raporteve të Shqyrtimit.	<i>Jo e zbatuar</i>	<i>KMRAP, SEKRETARI ATI</i>	MAP, së bashku me OECD/ SIGMA në qershor të vitit 2019 ka mbajtur takim për racionalizimin e agjencive. Konkretisht të agjencive që janë pjesë e raundit të dytë dhe të tretë në Planin e Veprimit për Racionalizimin e Agjencive. Takimi është mbajtur me ministrinë, agjencitë e të cilave janë në plan të rishikimit sipas Planit të Veprimit dhe janë pjesë e atyre ministrive
3.2.4	Krijimi i një sistemi për monitorimin e zbatimit të LOAP-it - Ligji për Organizimin e Administratës Publike.	<i>Jo e zbatuar</i>	<i>MAP</i>	Nuk ka zhvillime, për arsye se aktet nënligjore për zbatimin e Ligjit për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura janë miratuar në janar 2020
Objektiva specifike 3.3		Avancimi i mekanizmave për qasjen në dokumente dhe informacion publik për të siguruar publikimin proaktiv të koordinuar dhe të monitoruar nga niveli qendror për qasje në dokumente dhe informacione publike.		
Nr.	Aktivitetet	Gjendja	Institucioni	Sqarim i shkurtër mbi progresin
3.3.1	Miratimi i Ligjit për Qasje në Dokumente dhe Informacione Publike.	<i>E zbatuar</i>	<i>KUVENDI</i>	Ligji nr.06/L-081 për Qasje në Dokumente Publike ka hyrë në fuqi në korrik 2019. Autoriteti mbikëqyrës i zbatimit të këtij ligji është Agjencia për Informim dhe Privatësi. Hap i ardhshëm do të jetë hartimi i akteve nënligjore si dhe vazhdimi i shqyrtimit të ankesave të qytetarëve në shkallë të dytë Realizimi i këtij aktiviteti pritët përgjatë vitit 2020
3.3.2	Hartimi dhe miratimi i rregullores për themelimin e mekanizmave për shqyrtimin e ankesave për qasje në dokumente dhe informacione publike.	<i>Jo e zbatuar</i>	<i>AIP</i>	Në mungesë të titullarit, ky autoritet ende nuk ka arritur të hartojë aktet e brendshme të këtij ligji. Institucionet publike kanë filluar raportimin vjetor në AIP. Ankesat e qytetarëve në AIP kanë filluar të shqyrtohen. Në shumicën e rasteve, institucionet publike i janë bindur vendimeve të AIP dhe kanë ofruar qasje për qytetarët pas trajtimit të ankesave nga AIP. Hap i ardhshëm- Hartimi i testit të dëmit për t'ia lehtësuar punën ZQDP të institucioneve publike. Pritët realizimi në gjysmën e parë të vitit 2020
3.3.3	Caktimi i zyrtarit përgjegjës për qasje në dokumente, informacion publik dhe hapje të të dhënave në të gjitha institucionet.	<i>E zbatuar</i>	<i>AIP</i>	AIP ka të caktuar zyrtaren e saj përgjegjëse për qasje në dokumente publike, të dhënat e së cilës janë të publikuar në faqen zyrtare të autoritetit. Edhe në institucionet tjera publike është dërguar një qarkore nga AIP për përditësimin e listës së rrjetit ekzistues të ZQDP dhe/ose caktimin e një zyrtari të tillë aty nuk është caktuar ende. Aktualisht, brenda institucioneve publike janë të caktuar 146 ZQDP. Hap i ardhshëm- Zgjerimi i rrjetit të

				zyrtarëve për qasje në dokumente publike edhe në 24 institucione që nuk kanë caktuar një ZQDP, si dhe decentralizimi i rrjetit ekzistues të ZQDP. Realizimi planifikohet të bëhet gjatë tërë vitit 2020
3.3.4	Ndryshimi (hartimi) i rregullorës për standardet e faqeve zyrtare në bazë të koncept dokumentit të miratuar.	<i>Jo e zbatuar</i>	ZKM	Aktivitetet e AIP-së për hartimin e kësaj rregulloreje mund të fillojnë vetëm pas kalimit të tremujorit të parë të vitit 2020, duke llogaritur në mbështetjen e Projektit të Binjakëzimit, i cili pritet të fillojë më 1 prill 2020
3.3.5	Standardizimi i uebfaqeve në bazë të rregullorës nga ana teknike dhe permbajtësore.	<i>Jo e zbatuar</i>	ZKM/ASHI	
3.3.9	Promovimi i të dhënave të hapura dhe mbështetja e zbatimit të iniciativës së të dhënave të hapura.	<i>E zbatuar</i>	MAP/ASHI+DRAP IE	Në përputhje me rekomandimet e Raportit për Vlerësimin e Gatishmërisë për Hapjen e të Dhënave (ODRA) dhe Kartën për të Dhëna të Hapura, Qeveria e Republikës së Kosovës ka aprovuar vendimin për Organizimin dhe Funksonimin e Strukturave Institucionale për të Dhëna të Hapura. Hap i ardhshëm- Publikimi dhe popullimi në numër sa më madh të data seteve, në Portalin Shtetëror për të Dhënat e Hapura. Publikimi dhe popullimi i data seteve, në Portalin Shtetëror për të Dhënat e Hapura është i vazhdueshëm
Objektiva specifike 3.4		Autoritetet publike krijojnë mekanizma të cilat marrin përsipër borxhet në rast të shkeljeve dhe të cilët garantojnë korigjim dhe/ose kompensim adekuat.		
3.4.1	Hartimi i koncept dokumentit për përgjegjësinë jashtëkontraktore të administratës publike.	<i>Jo e zbatuar</i>	DL	Ekziston drafti i parë i Koncept Dokumentit për përgjegjësinë jashtëkontraktore të AP.